REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
138, 139, 141, 143 /22
Nr/Br.
Datë/Datum. 31.05.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	16.05.2022	31.05.2022

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.05.2022, OE "Granit", ka parashtruar ankesë me nr: 138/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës per Lot 2 dhe 3, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 2" dhe (Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 3, me nr. të prokurimit: 205-22-865-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MMPHI.

Me datën: 13.05.2022, OE "Integral", ka parashtruar ankesë me nr: 139/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës per Lot 2 dhe 3, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 2" dhe (Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 3, me nr. të prokurimit: 205-22-865-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MMPHI.

Me datën: 13.05.2022, OE "Via Egnatia", ka parashtruar ankesë me nr: 141/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës per Lot 2 dhe 4, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 2" dhe Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 4, me nr. të prokurimit: 205-22-865-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MMPHI.

Me datën: 13.05.2022, OE "Integral", ka parashtruar ankesë me nr: 143/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës per Lot 1 dhe 3, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 1 dhe (Mirëmbajtjen dimërore të autoudhës A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 3, me nr. të prokurimit: 205-22-865-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MMPHI.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: MIRËMBAJTJEN VERORE DHE DIMËRORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA)
Llot 1 - 1,828,000.00 € .
Llot 2 - 1,518,000.00 € dhe

MIRËMBAJTJEN VERORE DHE DIMËRORE TË AUTOUDHËS A6 (ARBËR XHAFERI)
Llot 3 - 1,011,000.00 €
Llot 4 - 1,121,000.00 €

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 16.02.2022, data e hapjes së ofertës: 14.03.2022, data e vendimit për dhënien e kontratës: 22.04.2022, data e njoftimit të me letër standarde: 22.04.2022.
Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

138/22

Kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar permes platformes se e-prokurimit me date 27.04.2022:

Kërko **Kërkesat për rishqyrtim**

Data e krijimit ▼	Përshkrimi	Kodi intern i procedurës	Emërtimi i procedurës	Statusi i procedurës	Data e dërgimit të kërkesës
icijaKorisnika/PregledHitMailovaFrm.aspx)			1. MIREMBAJTJEN DIMERORE TE AUTOUDHES A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 1 DHE LLOT 2		
iFrm.aspx? 27.04.2022 10:09		205-22-865-2-1-1	DHE 2. MIREMBAJTJEN DIMERORE TE AUTOUDHES A6 (ARBER XHAFERI) LLOT 3 DHE LLOT 4	Ne vlerësim	27.04.2022 10:15
iFrm.aspx?)					

Edhepse ka kaluar afati maksimal (3+3=6 dite), **AK nuk na ka kthyer kurrfare pergjigje akoma!**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo- Diskriminimi;
Neni 56. 3. Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 108/A pika pika 6.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

GRANITI

a/. AK – MMPHI e ka eliminuar oferten tone ne kundershtim me dispozitat e LPP dhe RRUOPP
b/. AK – MMPHI ka shpallur fituese ofertat e Grupeve te OE ne kundershtim me dispozitat e LPP dhe RRUOPP (te papergjegjshem por edhe me te shtrenjte!).

Ne vijim arsyetimi:

AK – MMPHI ka eliminuar oferten tone me arsyetimin se nuk kemi ofruar deshmite mbi:
1. mundesite teknike dhe / ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 pika 8 – kapaciteti teknik dhe profesional – plani i veprimit dhe shperndarjes se kripes sipas specifikacionit teknik te DT
Deshmia 8 – plani duhet te jete i pergaditur ne menyre sa me te detajuar, i nenshkruar dhe i vulosur,
2. nuk kemi bashkengjitur ne oferten tone Specifikimet teknike te detyrueshme.

Pika 1.
Lidhur me pretendimin e AK se *"OE Granit ka ofruar vetem disa vizatime te cilat nuk permbushin kerkesat sipas specifikacionit teknik dhe askund nuk permendet koha e reagimit e cila eshte max. 2 ore"* deklarojme se:

- Planet-skicat e ofruara (te nenshkruara dhe te vulosura nga ana jone) ne fakt jane punuar mbi harten e rrjetit rrugor te cilen AK e ka ofruar ne DT. Keto skica paraqesin ne menyre te qarte dhe te dukshme rrugetimin e secilit borepastrues gjate kohes se pastrimit dhe shperndarjes se kripes. Nuk ka se si te jene me te detajuara se sa te tregojne rrugetimin e secilit automjet. Ndersa lidhur me ate qe AK pretendon se nuk i kemi dorezuar sipas kerkesave te specifikimit teknik, ja se çka shkruan ne Specifikimet teknike lidhur me planet per pastrim dhe shperndarje:

"*3.2 **Planet për Pastrim dhe Shpërndarje***
Zbatimi i shërbimeve të pastrimit të borës dhe shërbimeve të shpërndarjes paraqet nevojën e një planifikimi të saktë të rrugëtimit ditor gjatë ditëve me të reshura bore. Siç është e përcaktuar nga plani vjetor per mirembajtjen dimerore"

Andaj, pyesim, **cilen kerkese te nenit 3.2- Planet për Pastrim dhe Shpërndarje te specifikimeve teknike nuk e paskemi plotesuar?**
Prandaj, AK nuk mund te eliminoje oferten tone per nje deshmi-kerkese qe nuk eshte specifikuar – kerkuar ne DT – specifikimet teknike!

- Lidhur me pretendimin e AK se *"askund nuk permendet koha e reagimit e cila eshte max. 2 ore"* deklarojme gjithashtu se, **as ne Specifikimet teknike te ofruara nga AK askund nuk permendet nocioni *"koha e reagimit"***. Prandaj, edhe ne kete pike **AK nuk mund te eliminoje oferten tone per nje deshmi-kerkese qe nuk eshte kerkuar ne specifikimet teknike te DT!**
  Nese analizohen planet e ofruara per pastrim-shperndarje, lehte konstatohet se secili segment rrugor ne keto plane pastrohet per me se shumti 1.5 ore.

- Lidhur me pretendimin e AK se *lokacioni i bazes se prezantuar gjendet ne largesi te konsiderueshme*, ju rikujtojme pergjigjen tuaj te dates 03.03.2022 ne pyetjen e OE Victoria Invest Internacional Group lidhur me kete çeshtje:

"sa i perket distances minimale mes objekteve percjellese dhe brezit rrugore nuk eshte e perckatuar se sa duhet te jete kjo distance, OE keto objekte percjellese duhet ti kete brenda territorit te Republikes se Kosoves, ndersa shpenzimet e transportit dhe te tjera duhet ti barte vete kompanija ."

Perderisa baza jone ndodhet ne Istog (e Istogu ndodhet brenda territorit te Republikes se Kosoves), **pretendimi i AK per largesine e Bazes se ofruar nuk qendron dhe per pasoje oferta jone nuk mund te eliminohet per kete pretendim.**

Pika 2.
Pretendimi i AK se *"OE bazuar te sksioni II. Fleta e te Dhenave te Tenderit (FDT) Aneski 1. nuk ka bashkengjitur ne oferten e tij SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME"* **nuk qendron.**

Ja se çka eshte shkruar ne Dosjen e Tenderit tek Aneksi 1.:

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Keni te bashkangjitur ne platformen E- Prokurimi

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Siç shihet, ne DT, eshte shenuar vetem informacioni per ofertuesit se Specifikimet teknike jane te bashkengjitura ne platformen E-prokurimi nga ana e AK. **Pra, nuk eshte kerkuar qe Specifikimet teknike duhet te bashkengjiten ne DT edhe nga ana e OE ofertues.**

Perderisa specifikimet teknike jane ngarkuar nga AK, ato jane pjese perberese e DT se bashku me gjithe dokumentacionin tjeter te ngarkuar nga ana e AK (Njoftimi per kontrate, Dosja e Tenderit, Specifikimet teknike te detyrueshme, Paramasat me parallogari, sasite indikative, vendimet e AK per kerkesat e OE, pergjigjet ne pyetjet e OE, etj).
Tek e fundit, secili OE ofertues ne momentin qe dorezon Formularin per dorezimin e Tenderit i ka pranuar pa asnje kufizim te gjitha dokumentet qe perbejne Dosjen e tenderit – perfshire ketu edhe specifikimet teknike te ngarkuara nga Autoriteti Kontraktues ne platformen E-prokurimi:

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 205-22-865-2-1-1

Titulli i kontratës: 1. MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 1 DHE LLOT 2 DHE 2. MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 3 DHE LLOT 4

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

Si perfundim, AK nuk ka te drejte te eliminoje oferten tone me pretendimin se ofertes sone nuk i kemi bashkengjitur specifikimet teknike te detyrueshme, perderisa askund ne DT nuk e ka kerkuar nje gje te tille.

Informacion shtese:

Duke u bazuar ne arsyetimin e eliminimit te ofertes sone dhe duke marre parasysh faktin se AK, gjate vleresimit te ofertave, ka pasur mundesi te na kerkoje sqarime lidhur me planet e pastrimit dhe shperndarjes (por qe nuk e ka bërë), ju sqarojme se:
Planet e pastrimit-shperndarjes te dorezuara ne DT, sikurse edhe gjate procedurave te meparshme te tenderimit per Mirembajtje dimerore (20 vitet e fundit), gjithnje jane skica qe tregojne fillimin, rrugetimin dhe perfundimin e segmentit te caktuar rrugor.
OE qe jane shpallur fitues, ne planet e tyre nuk kane treguar fare fillimin, rrugetimin dhe perfundimin e pastrim-shperndarjes per segmentet e caktuara. Per me teper as nuk i kane caktuar se cilin segment cili automjet do e pastroje! Megjithekete, jane shpallur fitues!!
Njesoj sikur neve, edhe ofertuesit e shpallur fitues, nuk kane planifikuar qe te perdorin si baza te mirembajtjes Bazen e ofruar ne DT. Mjafton ti shikosh planet e pastrimit qe i kane dorezuar ne ofertat e tyre!!
Nese analizohen nga persona qe kane njohuri elementare per kete çeshtje, skicat tona paraqesin ne menyre te detajuar rrugetimin e secilit automjet. Prandaj ato nuk jane "vizatime" por plane – skica te punuara mbi harten e dorezuar nga AK ne DT,

mjaftueshem te detajuara per qellimin e deshmimit se cili automjet cilin segment rrugor e pastron dhe trajektoren e rrugetimit.
Nese analizohen me kujdes, planet per pastrim-shperndarje te ofruara per Lotet qe kemi ofertuar, lehte mund te shihet qe, me qellim te shkurtimit te kohes se nevojshme per pastrim-shperndarje bazat e mirembajtjes jane në afersi te Lotit per te cilin do te jemi kontraktor i perzgjedhur dhe ate:
Per Lot-2 fillimi i pastrimit eshte nga nyja ne Fushe Kosove;
Per Lot-3 fillimi i pastrimit eshte nga nyja Lipjan;
Per Lot-4 fillimi i pastrimit eshte nyja Doganaj.
Qellimi eshte qe bazat te vendosen afersisht ne mes te Lotit perkates (afer nyjes me te aferme me mesin e gjatesise se lotit).
Duke u bazuar ne specifikimet teknike te DT:

Pika 3. Punët Përgatitore:

- *Përgatitja dhe caktimi i punktit për deponimin e materialeve për shkrirjen e borës dhe akullit , Akomdimin e stafit udhëheqës , punëtorëve dhe mekanizimit për pastrimin e bores*

Pika 3.3 Bazat e Mirembajtjes dhe deponimi i kripë

- *Para fillimit të sezonës dimrore, duhet të përgatitet Depoja për magazinimin e kripës. Depoja duhet të jetë e mbuluar, me kapacitet të mjaftushëm, për tu deponuar sasia e kërkuar e kripës . Depoja duhet të jetë e mbrojtur nga ndikimet e lagështisë .*
- *Kontraktuesi duhet të siguroj bazë të mirëmbajtjes duke perfshirë këtu zyre, strehë për automjete dhe pajisje si dhe depo të mbuluar dhe të mbrojtur nga depërtimi i lagështisë , për deponimin e kripës . Ketu duhet te perfshihet dhe nje zyre e ngrohur dhe e ndriçuar per Projekt Menaxherin (mbikëqyrësin).*

Siç eshte percaktuar ne specifikimet teknike, **Bazat e mirembajtjes duhet te pergaditen para fillimit te sezones dimrore**. Prandaj, neve kemi planifikuar se, perveç bazes se ofruar ne DT (e cila sherben per plotesimin e kerkeses se DT) do te pergadisim edhe bazen e mirembajtjes gjithsesi para fillimit te sezonit dimeror ne afersi te Lotit per te cilin do te jemi kontraktor i perzgjedhur dhe ate:
Per Lot -2 ne Fushe Kosove (afer nyjes Fushe Kosove);
Per Lot -3 ne Suhodoll (afer nyjes Lipjan).
Per Lot-4 ne Doganaj (afer nyjes Doganaj)
Bazuar ne praktiken e deritashme, te gjithe Kontraktoret deri me sot, bazen e kane krijuar pas nenshkrimit te kontratave dhe ate gjithnje ne afersi te Autostrades, perkatesisht Lotin te cilin jane kontraktuar.
Sipas specifikimeve teknike, pergaditja - sigurimi i bazave te mirembajtjes per lotin perkates eshte aktivitet i paraparë për kontraktorin (*Kontraktuesi duhet të siguroj bazë të mirëmbajtjes duke perfshirë këtu zyre, strehë për automjete dhe pajisje si dhe depo të mbuluar dhe të mbrojtur nga depërtimi i lagështisë , për deponimin e kripës).*
Ne oferten tone, neve kemi ofruar bazen ekzistuese te mirembajtjes konform kerkesave tuaja ne DT duke marre parsysh edhe pergjigjen tuaj (te dates 03.03.2022) lidhur me lokacionin e bazes se mirembatjes dhe objekteve percjellese. Kjo baze eshte ofruar vetem si deshmi per kerkesen tuaj dhe gjithsesi ploteson kerkesen tuaj sipas pergjigjes se dhene OE Victoria Invest. Nuk ka asnje dyshim se pergjigja juaj ne pyetje gjithashtu paraqet pjese perberese te Dosjes se tenderit.

Eshte me se e sigurt qe, pervec OE te cilet kane kontrata aktive, asnje ofertues tjeter aktualisht nuk i ka bazat e mirembajtjes ngjitur me Lotet per te cilat kane ofertuar. Perndryshe, do te duhej qe per 55 ofertat e dorezuara, ne diten e dorezimit te ofertave pergjate Autostradave te ishin te gatshme 55 baza te mirembajtjes!!!

Si perfundim, pretendimi i AK lidhur me bazen e mirembajtjes se ofruar se kinse nuk i ploteson kerkesat e DT nuk qendron.

b/. Lidhur me grupet e OE te shpallur fitues, deklarojme se:

Me date 25.04.2022 kemi kerkuar qasje ne DT e OE te shpallur fitues dhe me 26.04.2022 nga na e AK na jane dorezuar (ne forme elektronike) Dosjet e OE te shpallur fitues, mirepo nga Dosja e Grupit te OE "2A Group" SH.P.K & NNT ABC SH.P.K & Jubica SH.P.K & "B CORP" SH.P.K. na jane dorezuar vetem disa nga dokumentat (ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi) me pretekstin e konfidencialitetit!

Nga Lista e dokumentave te dorezuar ne DT nga konzorciumi: "2A Group" SH.P.K & NNT ABC SH.P.K & Jubica SH.P.K & "B CORP" SH.P.K., me rastin e qasjes ne dokumenta, nga 28 fajlla te ngarkuar ne DT nga ana e konzorciumit ne fjale, nga ana e AK na jane dorezuar vetem 14 fajlla me dokumentat ne vijim si dhe formulari per dorezimin e tenderit.

Duke marre parasysh faktin se ne DT vetem njeri nga partneret e Konzorciumit ("2A Group") ka paraqitur kerkesen per konfidencialitet (ne cilesine e Operatorit Ekonomik) dhe 3 (tre) partneret tjere nuk e kane paraqitur kerkesen per konfidencialit, AK ka pasur per obligim qe te na ofroje te gjithe dokumentacionin e te 3 (tre) OE tjer pjesemarres ne Konzorcium. Mirepo nuk na e ka ofruar!
Per me teper, edhe nga OE "2A Group" ka filtruar edhe disa nga dokumentat qe qartazi nuk perbejne sekret afarist si psh. Listen e emimeve, vertetimet nga ATK, Gjykatat, Stafi, makineria, etj.

Bazuar ne faktet e mesiperme, neve kemi dyshime qe konzorciumi: "2A Group" SH.P.K & NNT ABC SH.P.K & Jubica SH.P.K & "B CORP" SH.P.K. ka edhe mungesa te tjera ne dokumentacion, pervec ketyre qe do i paraqesim ne vijim.
I mbetet ekspertit shqyrtues dhe OSHP-se qe te beje verifikimet e nevojshme lidhur me kete Konzorcium.
Ne baze te ketyre pak dokumentave qe na ka ofruar AK, deklarojme se konzorciumi "2A Group" SH.P.K & NNT ABC SH.P.K & Jubica SH.P.K & "B CORP" SH.P.K. eshte shpallur i pergjegjeshem dhe fitues ne kundershtim me dispozitat e LPP dhe RRUOPP, **se paku per arsyet ne vijim:**

1.) Tek Lista e kontratave te realizuar gjate 3 viteve te fundit (e bashkengjitur me kete ankese), ne piken 4 dhe 5 jane paraqitur dy kontrata:

NNT ABC	Mirembajtja Verore dhe Dimoerore e rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2017-2018-2019 nr.kont. 047/2018	2018	2021	3,239,324.45 €	Ministria e Infrastruktures
B-corp shpk	Pastrimi,larja e rrugeve dhe trotuareve,mirembajtja dimrore dhe interventime te ndryshme ne komunen e Gracanices	2018	2021	1,419,256.90 €	Komuna e Gracanices
TOTALI				6,756,005.16 €	

Ky informacion i dorezuar nga Konzorciumi "2A Group" SH.P.K & NNT ABC SH.P.K & Jubica SH.P.K & "B CORP" SH.P.K. është i pasaktë!!
Sepse, bazuar ne te dhenat e nxjerra nga e-prokurimi shihet se:

- NNT ABC nuk ka qene fare pjesemarres ne konzorciumin qe ka fituar kontraten e cekur "Rajoni Mitrovica 2" (shih te bashkengjitur njoftimin per dhenie te kontrates te publikuar nga Ministria e Infrastruktures me 26.03.2018).
- B Corp shpk nuk ka qene fare pjesemarres ne konzorciumin i cili ka fituar kontraten *"Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës"* (shih te bashkengjitur njoftimin per dhenie te kontrates te publikuar nga Komuna e Gracanices me 29.10.2018, ku fitues eshte shpallur Konzorciumi - *Grup i Operatorëve Ekonomik: P.T.P. "RAD"; "Europa Partners" SH.P.K.; " A- ABC " SH.P.K.; N.T. "Rahovica Comerce"*). Duke u bazuar ne njoftim per dhenie te kontrates, shihet se buxheti i parapare per kete kontrate kornize ka qene 600.000,00 Euro. Edhe sikur te kete pasur tejkalim te sasive prej max. 30% totali i puneve te kryera nuk mund te jete mbi 780.000,00 Euro. Prandaj, si eshte e mundur qe vlera e puneve te kryera te jete 1,419,256.90 Euro ?!?

Bazuar ne faktet e mesiperme, NNT ABC dhe B Corp Shpk nuk kane qene fare pjesemarres ne konzorciumet qe kane fituara ato dy kontrata!!

Per pasoje, kur perjashtohen keto 2 kontrata nga lista e kontratave, del se ky konzorcium nuk e ka plotesuar as kerkesen per:

Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e Mirëmbajtjes (2019, 2020 dhe 2021) jo më pak se Llot 2 = 4,500,000.00 €.

Si i tille, ky konzorcium eshte i papergjegjshem dhe nuk mund te shpallet fitues.

2.) Bazuar ne aktin noterial per makinerine e ofruar, shihet se noteri e ka specifikuar se:

Bazuar në kërkesën e përfaqësuesit të subjektit juridik me të dhënat si më larë në vendin e ngjarjes në F.Llapnasellë-Graçanicë, pra në Autoparkun e 2A Group SH.P.K. me të dhënat si

Faqja 1

1. Kompania NNT ABC SH.P.K. emri tregtar: NNT ABC me seli në Prishtinë, Rruga 20 Qershori, e regjistruar pranë MTI-ARBK me numër identifikues 811411751. Ka

2. Kompania B CORP SH.P.K. me seli në Prishtinë, Ekrem Rexha Nr.55A-1, e regjistruar pranë MTI-ARBK me numër identifikues 810603405 dhe të të vërtetës të nenet 48 dhe 49 të ligjit mbi Noterinë - Ligji Nr.03/L-010 i Republikës së Kosovës, mbrëvë

4.Me subjektin tjetër JUBICA SH.P.K. me seli në Sirkedër-Republika e Shqipërisë, Kompania 2A Group SH.P.K. ka [illegible] Marrëveshje [illegible] Operimi për krijuesit e punës [illegible] tendërës [illegible] Kontratës [illegible]

Pra, Kompania "2A Group" SHPK ka bashkuar asetet me NNT ABC SHPK, B-Corp SHPK dhe Jubica SHPK.

Mirepo, ne listen e makinerise jane futur edhe paisje qe nuk jane prone e asnjerit nga keta 4 (kater) OE te cilet i ka specifikuar noteri. Per shembull, ka paisje qe jane prone e kompanive "Europa Partners", "Alko Impex", "REJ SHPK", etj. Keto nuk jane shenuar ne aktin noterial i cili do te deshmonte se kane kontrate valide per marrjen me qira te paisjeve.

Pasiqe AK nuk na ka dorzuar kontratat e marrjes me qira te paisjve, nuk mund te konfirmojme me siguri se kane apo nuk kane kontrata valide ashtu sic eshte kerkuar ne DT. I mbetet ekspertit shqyrtues dhe OSHP-se te verifikoje keto dyshime.

Nje gje eshte e sigurt se, se paku 1 (nje) paisje e ofruar – Pozicioni 14. Traktor me fuqi min. 60 KF, nuk ploteson kerkesen qe traktori te kete se paku 60 Kale fuqi. Traktori i ofruar eshte IMT-539 qe sipas shenimeve te prodhuesit ka vetem 39 KF. Pra jo 60 sa eshte kerkuar.

Gjithashtu, tek pozicioni nr. 2. Cilinder vibrues me peshe 7-12 tona, jane ofruar 4 cope cilindra. Mirepo, asnjeri nga 4 cilindra te ofruar, nuk jane fare cilindra per ngjeshje te asfaltit.

Rrjedhimisht, konzorciumi ne fjale nuk ka plotesuar as kerkesat per makinerine e kerkuar.

3.) Nga Lista e dokumentave te dorezuar ne DT nga konzorciumi: "2A Group" SH.P.K & NNT ABC SH.P.K & Jubica SH.P.K & "B CORP" SH.P.K. nuk mund shihet se konzorciumi i ka dorezuar Kopjet e kontratave te kerkuar ne DT. Ngase AK nuk na ka dorezuar dokumentacionin relevant te kerkuar, shpresojme se Eksperti shqyrtues do e vertetoje se a jane dorezuar Kopjet e kontratave ashtu sic eshte kerkuar ne FDT.

4.) Neve besojme se Kozorciumi tjeter i shpallur fitues per Lot-3, pervec se eshte me i shtrenjte se oferta jone, eshte gjithashtu i papershtatshem ngase njeri partner (VIA) ka dorezuar certifikaten nga ATK e cila nuk permbush kerkesen specifike te FDT:

"Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve"

Ne vertetimin e OE "VIA" eshte shkruar se OE VIA eshte ne marreveshje me këste per te shlyer borxhe tatimore te mbetura.

Perderisa eshte ne marreveshje per te shlyer borxhe tatimore te mbetura, eshte me teper se e sigurt se eshte me vonese per pagesen e tatimeve. Perndryshe, sikur mos te ishte me vonese ne pagesen e tatimeve nuk do te kishte kurrfare nevoje te hyje ne marreveshje per pagesen e tatimeve te prapambetura!

Konkluzion:

Eliminimi i padrejte i ofertes sone nga ana e AK (bazuar ne faktet e sqaruara me siper) **si dhe shpallja fitues e ofertuesve qe nuk i kane permbushur disa nga kerkesat e DT** (bazuar dokumentacionin e ofruar nga AK me rastin e qasjes ne DT te OE qe jane shpallur fitues), **eshte ne kundershtim te plote me dispozitat ligjore dhe nenligjore ne fuqi.**

AK - MMPHI, përveç se mund të na shkaktojë dëme neve si OE, duke eliminuar ofertën tonë dhe duke shpërblyer OE tjere me te shtrenjte se oferta jone (por edhe te papergjegjeshem) do të dëmtoje edhe buxhetin e Kosovës per shuma të mëdha finansiare:

Per Lot-2 oferta e shpallur fituese eshte me e shtrenjte se oferta jone per shumen 104,701.46 Euro

Per Lot-3 oferta e shpallur fituese eshte me e shtrenjte se oferta jone per shumen 489,097.02 Euro

Andaj, kerkojmë nga OSHP që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet që do na shkaktohen jane te konsiderueshme. Si ne aspektin finansiar ashtu edhe ne demtimin e reputacionit te kompanise.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit
c) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
d) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,(nuk kemi pranuar kurrfare pergjigje akoma nga ana e AK)
e) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
f) Dorezimi i kerkeses per rishqyrtim.pdf
g) Lista e kontratave te realizuara.pdf
h) Njoftim per dhenje te kontrates MI 2018.pdf
i) Njoftim per dhenje te kontrates Gracanice 2018.pdf

139/22

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

INTEGRAL

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 22.04.2022 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së për Lot II ku e ka rekomanduar për kontratë grupin e OE 2A Group SH.P.K.; NNT ABC SH.P.K.; BCORP SH.P.K.; JUBICA SH.P.K., dhe për lot III e ka rekomanduar për kontratë grupin e OE DAMASTION PROJECT SH.P.K.; VIA SH.P.K.; Compania Eskavatori SH.P.K., ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetimin se:

Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe keto kerkese te DT - FDT-së, pasi qe ne oferten e tije Operatori Ekonomik ka ofruar doukemt nga Banka nga antari i konzorciumit Milenium Konstruktion shpk ne vleren prej 187,036.83 dhe nje tjeter doukemt nga Banka nga antari i konzorciumit Integral shpk ne vleren prej 50,647.03 ku ku keto vlera ne total kipin shifrat 237,683.86 €te cilatjane ne kundershtim me kerkesat e DT dhe te FDT-së, pasi qe nuk kapin shumen minimale per: Loti II. 900,000.00 €, Llot III. 600,000.00 € dhe Llot IV. 660,000.00 €.
OE bazuar tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Aneksi 1. nuk ka bashkangjitur ne oferten e tije SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Sa i përket arsyes së AK-së për eliminimin tonë në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, ju sqarojmë se arsyeja e lartcekur është e paqëndrueshme për faktin se ne e plotësojmë kërkesën në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar.
Kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë *"2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku*
Loti I. 1,080,000.00 €
Loti II. 900,000.00 €
Llot III. 600,000.00 €
Llot IV. 660,000.00 €. ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni."*

Në lidhje me kërkesën e lartcekur ne i kemi prezantuar në ofertë konfirmimin nga Banka ekonomike në emër të anëtarit të konzociumit Milenium Konstrukction Shpk, në vlerë 187,036.83 €, vërtetimin mbi gjendjes e llogarisë nga NLB Banka për Integral SH.P.K. në vlerën 50,647.03 € dhe vërtetimin e qarkullimit nga banka Procredit për Integral SH.P.K në vlerë prej 688,980.53 €. Kur mblidhen të gjitha vlerat e lartcekura shuma e përgjithshme del në total prej 926,664.39 €, shumë kjo që tregon se ne e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit tek kapaciteti ekonomik dhe financiar *"Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku: Loti II. 900,000.00 € dhe Llot III. 600,000.00 €"*.

Sa i përket vërtetimit të qarkullimit të lëshuar nga Procredit Bank për Integral SH.P.K., ju sqarojmë se me këtë dokument përveç vlerës së qarkullimit që ceket është e shënuar edhe bilanci i llogarisë në momentin e lëshimit të këtij dokumenti e që është në vlerën 688,980.53 €. Pra në këtë dokument ceket qartë se sa para të gatshme kemi pasur ne si kompani Integral SH.P.K. në llogari. Edhe kërkesa e FDT-së ka qenë që të dëshmohet se sa mjete të gatshme ka në gjirollogari kompania ofertuese, prandaj edhe dëshmia e ofruar nga ne është në përputhje të plotë me kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse AK-ja ka menduar që përbën dallim thelbësor emërtimi i dokumentit atëherë ju sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar në dispozita ligjore, sepse emërtimi i dokumentit nuk ka asnjë rëndësi, mirëpo e rëndësishme është konfirmimi se kompania i ka mjetet në gjirollogari në vlerën e cekur në atë dokument. Prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK që të analizoj edhe një herë dokumentet e ofruara nga ne në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, dhe të nxjerr një vendim të drejtë konform kërkesave dhe dëshmive të ofruar nga ne si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë për Lot 2 dhe 3.

Sa për të sqaruar gjendjen faktike në lidhje me mjetet që kanë qenë në gjirollogari në momentin që është lëshuar vërtetimi i qarkullimit, ne kemi kontaktuar me bankën edhe njëherë e ku e njëjta e ka lëshuar një shkresë-sqarim ku e konfirmon që informatat e lëshuara në vërtetimin e qarkullimit të dt.11.03.2022, janë të sakta dhe duhet të merren parasysh nga të gjitha palët e interesit sepse janë

dokumente zyrtare të bankës. **(Bashkangjitur keni sqarimin në fjalë).**

Në lidhje me arsyen e dytë të eliminimit sa i përket specifikimit teknik, ju sqarojmë se i gjithë dokumentacioni i tenderit është përgatitur në harmoni me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe të specifikimeve teknike të dosjes së tenderit, prandaj nuk ka qenë kërkesë decidive e dosjes së tenderit që të bashkangjitet i tërë dokumentacioni i specifikimeve teknike, por çka është më e rëndësishme ne i kemi ofruar të gjitha dëshmitë në lidhje edhe me makineritë të cilat janë kërkuar, e po ashtu edhe të gjitha dëshmitë që janë kërkuar si në FDT e ashtu edhe tek specifikimet teknike.
Andaj duke e pasur parasysh këtë fakt rezulton se ne si OE jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit dhe me këtë rast AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e neni 56.3 të LPP-së, i cili e përcakton qartë se *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."*

Andaj duke u bazuar në të gjitha arsyetimet e lartcekura, kuptohet qartë se ne si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht më i lirë për Lot 2 dhe 3, jemi eliminuar me arsyetime të pa bazuar dhe të pa qëndrueshme të cilat nuk janë të mbështetura në dispozita ligjore.

Për **Lot 2** AK-ja ka rekomanduar për kontratë grupin e OE **2A Group SH.P.K.; NNT ABC SH.P.K.; BCORP SH.P.K.; JUBICA SH.P.K.,** i cili OE është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Lista e pajisjeve, mjeteve dhe stabilimenteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Lista e pajisjeve duhet te jete e noterizuar nga Noteri sipas procedures EN - MINUTES Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit"*, ku tek lista e paisjeve është kërkuar **Traktor me fuqi min. 60 Kf me rimorkio.**
I njëjti OE e ka prezantuar traktorin 01-795-VA, IMT539,783, i cili traktor nëse kërkohet në internet me këto të dhëna të cilat i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë, atëherë si rezultat figuron se i njëjti ka prezantuar traktorin me të dhënat 39 hp dhe me fuqi 29.1 Kw, fakt ky që tregon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit në lidhje me traktorin, pasi që është kërkuar min. 60Kf, ndërsa e ka ofruar 29.1 Kw.

AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt duke e favorizuar haptas OE të rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. **(Bashkangjitur keni dëshminë për traktorin).**

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë për lot 2 është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e ka plotësuar dhe kërkesën tjetër në lidhje **me Pajisjet dhe mekanizmin e obligueshëm për mirëmbajtjen dimërore A7, ku i njëjti për kërkesat me nr.1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7,** ka prezantuar si dëshmi vetëm numrin e parcelës, ku ne si OE kemi qenë në vendin e kësaj

parcele dhe kemi bërë fotografi të cilat edhe do të ju bashkangjesim, ku figuron se e njëjta është bazë e asfaltit. Pra nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar, sepse në të njëjtën parcelë nuk figuron garazha e mbuluar për automjete, punëtoria me dhomë për ruajtje, vendi për ruajtjen e karburanteve për shërbime, strukturën e furnizimit me energji elektrike, zona e mbyllur për ruajtjen e kripës me platformë për ngarkesë-kapaciteti 750 t, qendra e përkohshme e komunikimit dhe as dhomat për stafin dhe punëtorët.

Për ne është e habitshme se si AK-ja e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk e plotëson njërën ndër kërkesat thelbësore të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi që në vend se të ofrohet parcela sikurse është kërkuar i njëjti OE ka ofruar parcelën në të cilën është baza për prodhimin e asfaltit. **(Bashkangjitur keni fotografitë e parcelës, të bëra nga ne si kompani).**
Po ashtu i njëjti OE nuk ka prezantuar fletë poseduese për parcelën në fjalë, po ashtu nuk ka prezantuar plan të situacionit, edhe pse në listë shkruan se e ka ofruar mirëpo nga dëshmitë nuk figuron askund. Gjithashtu të njëjtit i mungon edhe legjenda për destinimin e kthinave, ku nëse analizohen dëshmitë e prezantuara, kuptohet qartë se të njëjtat mungojnë dhe si i tillë ky OE është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti ka prezantuar në ofertë planin e veprimit dhe shpërndarjen për Lot 2, ku të njëjtit i figuron baza e mirëmbajtjes Fushë Kosovë, ndërsa parcela të cilën e ka bashkangjitur është në Llapnasellë dhe kjo vërtetohet nëse kërkohet me numër të parcelës në map-gjeoportal.

Në dokumentet e prezantuara nga OE i rekomanduar në ofertë, askund nuk figuron ndonjë dëshmi se i njëjti OE ka bazë të mirëmbajtjes në Fushë Kosovë, fakt ky që tregon se OE i rekomanduar për kontratë është munduar të manipuloj me planin e veprimit të shpërndarjes së kripës, përkatësisht bazën e mirëmbajtjes.

Gjithashtu ju sqarojmë se ne si OE kemi kërkuar qasje të plotë në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo që nuk na është lejuar qasja e plotë në dokumentet e të njëjtit. Gjatë qasjes neve nuk na janë dhënë dokumentet në lidhje me dëshmitë e kontratave dhe referencave, dëshmitë për makineritë, dëshmitë në lidhje me stafin teknik dhe profesional, çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë etj.

Me këtë veprim AK-ja ka shkelur nenin 10.3 të LPP-së, prandaj ne dyshojmë se të gjitha dëshmitë për të cilat nuk na është lejuar qasja në dokumente, OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson.
Sa për sqarim ju rikujtojmë që OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka ofertuar me çmim 123,262.41 €, ndërsa ne kemi ofertuar me çmim 88.89 € për njësi, prandaj rezulton se ne kemi ofertuar me çmim jashtëzakonisht më të ulët se sa OE i rekomanduar për kontratë dhe me veprimin tuaj rrezikohet të dëmtohet buxheti i shtetit.

Për **Lot 3** AK-ja ka rekomanduar për kontratë grupin e **OE DAMASTION PROJECT SH.P.K.; VIA SH.P.K.; Compania Eskavatori SH.P.K.**, i cili OE nëse analizohen çmimet për njësi rezulton se ne jemi OE dukshëm më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë për këtë lot, ku ne kemi ofertuar me çmime prej 65.64 € për njësi, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim 88,472.00 € për njësi. Nëse do të llogariteshin këto çmime me sasitë indikativë për tri vite atëherë rezulton se ne jemi më të lirë në vlerën prej 734,193.18 €, në total për tri vite, aq sa parashihet të zgjat kontrata. Nëse analizohet çmimi vjetor me sasitë indikativë atëherë rezulton se oferta jonë është me çmim më të lirë për vit në vlerën prej 244,731.06 €.

Nga ky fakt kuptohet se ne si OE është dashur të rekomandohemi për kontratë për Lot 3 dhe jo OE të cilin e ka rekomanduar për kontratë AK-ja.

Ne me dt.27.04.2022 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim të cilën e kemi dërguar tek AK-ja përmes emailit dhe e kemi ngritur në e prokurim, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje në lidhje me kërkesën tonë për rishqyrtim.
Dita e tretë për të kthyer përgjigjje ka rënë në ditë vikendi dhe më pastaj ka vazhduar edhe me festat zyrtare, ku ka qenë pushim edhe dt. 02 dhe 03.05.2022 (e hënë dhe e martë). Ndërsa dita e tretë pune për të kthyer përgjigjje i ka rënë me dt.04.05.2022 (e mërkurë), që i bie se dita e fundit për kthimin e një përgjigjje ka qenë kjo datë pra **04.05.2022.**

Përderisa kanë kaluar të gjitha afatet kohore për kthimin e një përgjigjje nga ana e AK-së sa i përket kërkesës tonë për rishqyrtim, ne jemi të detyruar të parashtrojmë ankesë në OSHP, pa pranuar përgjigjje.

Gjithashtu veprimi i AK-së për mos nxjerrjen e një vendimi në lidhje me kërkesën tonë për rishqyrtim, e tregon edhe një herë qartë faktin se si po diskriminohemi ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë në lotet e lartcekura, nga ana e AK-së. Po ashtu përderisa ne nuk kemi pranuar një vendim në lidhje me kërkesën tonë për rishqyrtim, po vërtetohet fakti se pretendimet tona janë të bazuara, sepse në të kundërtën nëse të njëjtat pretendime do të ishin të pa bazuara atëherë AK-ja do të na kishte kthyer një përgjigje konkrete për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.* Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse,* mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e a respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, **kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit për lotet (II dhe III) e lartcekura ne jemi OE më i lirë.**

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Integral" Sh.p.k &"Milenium Konstruction" Sh.p.k& "NITI-N" SH.P.K**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për **Lot 2 dhe 3** dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

A41/22

4. **AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së**
5. **AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së**
6. **AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së,**
7. **AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,**
8. **AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së**
9. **AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,**
10. **AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim. VIA EGNATIA

Ne vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet që e mbështesin pretendimin tonë për shkeljet e dispozitave të LPP-së nga ana e AK-së.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejt ka shpërblyer me kontratë dy Grupe të OE (Lot 2 dhe lot 4) të cilët nuk i plotësojnë kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe në të njëjtën kohë na ka eliminuar neve gjoja si të papërgjegjshëm edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit saktë ashtu siç i kishte kërkuar AK. Përpos kësaj ne kemi pasur edhe çmimin tenderit më të ulët se sa Grupi i OE të shpallura si fitues për **1,131,949.83€ - afër 50%** për **Lot 2** në periudhën **36 mujore** ndërsa OE i shpallur fitues për Lot 4 në periudhën **36 mujore** është më i lirë se ne vetëm për **5518.89€** për përudhën **36 mujore** por që i njëjti është plotësisht i papërgjegjshëm.
Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve të cekura më lartë.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër mangësive të theksuara në ofertat e këtyre Grupeve të OE, ata favorizohen dhe shpërblehet me kontrata ndërsa në të njëjtën kohë ne diskriminohemi edhe pse i plotësojmë të gjitha kriteret e dosjes së tenderit dhe posedojmë çmimin shumë më të ulët për të dy lotët e cekura.
Vlen të theksohet se Grupet e OE të shpallur fitues për Lot 2 dhe Lot 4 nuk posedojnë dëshmi të rregullta lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet e ofruara si dhe nuk posedon dëshmi të rregullta lidhur me licencat, marrëveshjet, konzorciumet e shumë mangësi tjera. Këto dokumente shihen qartë se janë të manipuluara dhe qëllimisht AK nuk na ka dhenë qasje në disa nga to duke vepruar në kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të LPP-së andaj trajtimi i tyre si të rregullta nga ana e

AK-së konsiderohet favorizim i plotë. Kjo nuk është vetëm favorizim po në një formë është edhe bashkëpunim në mashtrim pasi që Grupet e OE në fjalë nuk janë të përgjegjshëm, posedojnë çmimin shumë më të lartë se ne dhe pavarësisht kësaj AK i shpërblen me kontratë. Detajet e mangësive në ofertat e këtyre Grupeve të OE do ti shpalosim në pretendimin 4 ku do të argumentojmë edhe gabimet dhe shkeljen e AK-së me rastin e eliminimit tonë si Grup i OE i papërgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.
Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë dhe të barabartë të tenderuesve.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1 të këtij nenin sepse gjatë vlerësimit të ofertës tonë ka vepruar në kundërshtim me pikën 3 të këtij neni duke aplikuar kritere dhe kërkesa që nuk i ka pasur fare në dosjen e tenderit. Neni 56.1 i LPP-së shumë qartë e thotë se:

56.1 Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
56.1.1 së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;
56.1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

AK nuk ka respektuar aspak këto që thotë neni 56.1 i LPP-së sepse Grupet e OE që i ka shpallur fituese i ka cilësuar si të përgjegjshëm edhe pse realisht janë të papërgjegjshëm. E themi këtë sepse Grupet e OE që AK i ka shpallur fitues kanë mangësi të theksuara në ofertat e tyre dhe këto mangësi pasqyrojnë edhe tentativën për të mashtruar dhe lajthitur AK-në me dëshmi të manipuluara.
Përpos kësaj, AK tek oferta jonë ka aplikuar kritere në kundërshtim me formën si i ka kërkuar në dosjen e tenderit e që veprimi i tillë bie në kundërshtim të plotë me nenin 56.3 të LPP-së. Ky nen shumë qartë e përshkruan se:

56.3 Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tek vlerësimi i ofertës tonë AK ka aplikuar si kriter shtesë dorëzimin e Aneksit 1 të dosjes së tenderit edhe pse askund nuk është cekur se duhet të dorëzohet si dokument. Ka aplikuar si kriter shtesë kërkesën për vlerën e projekteve të realizuara ku referencat ton në emër të grupin i ndan dhe i zvogëlon sipas qejfit të tyre edhe pse kjo nuk ka qenë e kërkuar në dosje të tenderit. Gjithashtu ka aplikua edhe kriterin e përpilimit të kontratave në zyrën e noterit e që në kërkesën e paraqitur tek FTD-ja nuk ka qenë e përcaktuar. Pra këto kërkesa nuk kanë qenë kërkesa mandatore të vendosura tek FTD-ja ndërsa AK i aplikon në kundërshtim me nenin në fjalë. Aneksi 1 i dosjes së tenderit për kontrata të shërbimeve është vetëm informator se si do të ofrohen shërbimet ku edhe tregon kapacitetin e nevojshëm që duhet përmbushin OE për kryerjen e shërbimeve të tilla. Në këtë raste askund nuk e ka cekur se kjo dëshmi duhet të ofrohet drejtpërdrejt nga tenderuesi apo ndonjë anëtar i konzorciumit ndërsa gjatë vlerësimit e aplikon si të tillë duke vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së. Ne i kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë e nevojshme sipas FTD-së dhe ato që janë kërkuar tek Aneksi 1 ndërsa tek formulari i tenderit jemi deklaruar se i pranojmë dispozitat e dosjes së tenderit në tërësi, pa rezervim ose kufizim, që nënkupton se e pranojmë edhe atë që është kërkuar tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit.

Dëshmitë që tregojnë se jemi në rregull me kërkesat e Aneksit 1 – Specifikimit Teknik i gjeni të bashkangjitura kësaj kërkese ndërsa deklaratën e lidhur me pranimin e të gjitha dispozitave të dosjes së tenderit në tërësi, pa rezervim ose kufizim po ua paraqesim në formë vizuele në vazhdim.

Titulli i kontratës: 1, MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 1 DHE LLOT 2 DHE 2. MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 3 DHE LLOT 4

Si përgjigje ndaj letrës suaj të fresës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

Bazuar në sqarimin dhe argumentimin e mësipërm, konstatohet se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 56 të LPP-së dhe rrjedhimisht edhe e ka shkelur atë në tërësi.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne konsiderojmë se ky nen është shkelur me rastin e vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht të tenderit tonë.
Në vazhdim po e paraqesim secilën shkelje që AK e ka bërë gjatë vlerësimit të tenderit tonë si dhe po i paraqesim edhe shkeljet që i ka bërë gjatë vlerësimit të tenderëve që AK i ka shpallur fitues tek Lot 2 dhe Lot 4.
AK gjatë vlerësimit të tenderi tonë gabimisht ka konstatuar se ne kemi mangësi në disa pika të tenderit tonë e të cilat nuk përkojnë me realitetin që mbretëron në të vërtetë. Pikat në të cilat na ka eliminua AK janë këto:

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT – FDT-së, pasi qe ne oferten e tije Operatori Ekonomik ka ofruar nje Deklaratë nga Banka e cila eshte ne kundershtim me kerkesat e DT dhe te FDT-së, pasi qe ky dokument eshte leshuar ne forme te kushtezuar.

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, menaxheri i projektit i caktuar per kete aktivitet te prokurimit, i mungon kontrata e noterizuar sipas kerkesave te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se kontrata e punës me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndersa kontrata e menxherit te projektit eshte e noterizuar vetum nga punemarrsi (menaxheri i projektit) e jo edhe nga punedhenesi (kompanija), andaj kjo kontrate pune, bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, Udheheqes i Punishtes i caktuar per kete aktivitet te prokurimit, i mungon kontrata e noterizuar sipas kerkesave te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se kontrata e punës me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndersa kontrata e menxherit te projektit eshte e noterizuar vetum nga punemarrsi (menaxheri i projektit) e jo edhe nga punedhenesi (kompanija), andaj kjo kontrate pune, bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së. Udheheqes i Punishtes ka te prezantuar vetum 1 reference nga lemija e kerkuar .

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, Inxhinier i diplomuar i komunikacionit i caktuar per kete aktivitet te prokurimit, i mungon kontrata e noterizuar sipas kerkesave te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se kontrata e punës me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar, ndersa kontrata e Inxhinier i diplomuar i komunikacioniteshte bere jasht zyres se noterit, andaj kjo kontrate pune, bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së.

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, lista e kontratave nuk permbushin kerkesat te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se OE duhet te kete kontrata te realizuara dhe te perfunduara ne lëmine e Mirëmbajtjes, te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokine, për periudhën e shkuar tre vjeçare (2019, 2020 dhe 2021) jo më pak se Llot 1 = 5,400,000.00 €, Llot 2 = 4,500,000.00 €, Llot 3 = 3,000,000.00 € dhe Llot 4 = 3,300,000.00 €, Operatori ekonomik ka prezantuar kontrata ne vlere prej 1,840.000.00 € nga lemia e Mirëmbajtjes , te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokiae, për periudhën e shkuar tre vjeçare (2019, 2020 dhe 2021), andaj kjo kerkese bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së.

- OE bazuar tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Aneksi 1. nuk ka bashkangjitur ne oferten e tije SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Asnjëra nga këto arsyetime të atribuara nga ana e Komisionit të Vlerësimit si mangësi në tenderin tonë nuk janë të vërteta sepse gjendja në tenderin tonë është krejt ndryshe.
Në vazhdim po e argumentojmë të kundërtën për secilën prej mangësive të përcaktuara nga Komisionit të Vlerësimit:

Arsyetimi i parë për anulim i komisionit të vlerësimit për gjoja se LETËR KONFIRMIMI nga banka është i kushtëzuar nuk qëndron sepse shumë qartë shihet që banka e ka cekur që nëse ne shpallemi fitues, do të mundemi të kemi qasje në kredi në vlerë prej 1,080,000.00€

Nëse e kërkon klienti, Banka synon që të kryejë vlerësimin e kapacitetit të kompanisë së biznesit VIA EGNATIA SHPK për qasje në linja kreditore dhe/apo produkte të tjera bankare. Vlerësimi do të bëhet në bazë të politikave dhe procedurave të TEB SH.A. të Alokimit të Kredive dhe duke u bazuar në vlerësimin e kapacitetit financiar të klientit në rast se klienti kërkon limit kreditor në shumë prej EUR 1,080,000 euro, nëse kompania në fjalë përzgjidhet për implementim të projektit përmes procesit të ofertimit/tenderimit.

Pasusi i cekur se banka do të bëjë vlerësimin e kapacitetit financiar të klientit është për rastet kur kompania kërkon qasje në kredi apo produkte tjera pa përfshi kontratën që pritet ta fitoj ndërsa në qoftë se kontrata fitohet atëherë kapaciteti financiar konsiderohet është i plotësuar sepse kthimi i kredisë bëhet nga mjetet që kompania paguhet gjatë kryerjes së shërbimeve. I vetmi kushtëzim është se dokumenti mundet të përdoret vetëm për tenderim dhe qasja në kredi lejohet vetëm nëse kompania shpallet fituese e kontratës, për çka është edhe qëllimi i marrjes së këtij letër konfirmimi. Pra parimisht këtu nuk ka asnjë kufizim dhe se Komisioni i Vlerësimit e ka përdorur këtë si shkas vetëm sa për të na eliminuar nga konkurrenca me çka vetëm tek Lot 2 e dëmton buxhetin e shtetit për **1,131,949.83€.** Sipas kësaj që thamë më lartë shihet se ky Letër Konfirmim e plotëson kushtin e dosjes së tenderit dhe si i tillë duhet të pranohej kusht i plotësuar.

Arsyetimi i dytë për anulim që lidhet me atë se gjoja noterizimi i kontratës për menaxherin e projektit është bërë pa praninë e të dy personave të kanë nënshkruar këtë kontratë, nuk qëndron fare sepse tek vërtetimi i noterit shumë qartë ceket se: Nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur "kontratë pune" e lidhur më dt. 11.03.2022 është vënë nga punonjësi dhe punëdhënësi, ndërsa më poshtë e cek qartë se këto nënshkrime të palës janë vënë në praninë tijë. Po ashtu shumë qartë i përshkruan personazhet që dëshmon mjaftueshëm se noterizimi është bërë me pranin e të dy personave që për noterin konsiderohen palë. Shihe aktin noterial të paraqitur më poshtë në formë vizuele. Sipas kësaj që thamë më lartë dhe sipas asaj që shihet tek akti noterial, vërehet qartë se noterizimi është bërë në prani të të dy palëve dhe se kushti i dosjes së tenderit plotësohet saktë ashtu siç ishte kërkuar.

Vërtetim nënshkrimi

Sot, më date 11.03.2022 (njëmbëdhjetë mars dymijë e njëzet e dy) para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli në Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n , vërteton se:

Nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur "Kontratë punë" e lidhur me dt.11.03.2022, është vënë nga:

1. **Z.Skender Muçolli** i lindur në Bajçinë ,më dt.25.04.1949 (njëzet e pesë prill njëmijë e nëntëqind e katërdhjetë e nëntë),me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, shtetas i Republikës së Kosovës,bartës i letërnjoftimit me nr.personal:1011135451 lëshuar nga MPB-Prishtinë me dt 25.09.2014, valid gjer më 24.09.2024, madhor me zotësi të plotë veprimi.(Punonjësi).

2. **Z.Gene Muçolli** i lindur në Prishtinë, më dt.15.08.1992 (pesëmbëdhjetë gusht njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) me vendbanim në Prishtinë ,shtetas i republicës së Kosovës,bartës i letërnjoftimit me nr. personal:1500406379, të lëshuar nga MPB Prishtinë më 03.01.2020,valid gjerë më 02.01.2030, madhor me zotësi të plotë veprimi(Përfaqësues i **"Via Egnatia" sh.p.k-Punëshënësi**)

Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit të përpiluar jashtë zyrës së tij , noteri vetem vërteton nënshkrimin e palës të vënë në pranimë e tij dhe në zyrën e tij.

Ky akt lëshohet en brevet. Tarifa është paguar sipas UA nubi Tarifat e përkohshme noteriale për çdo nënshkrim 1€ = 1 x 4 nënshkrime që në total për tetë nënshkrime kap shumën prej 4€+1€ **vendosjen e vinjetit të vulës (neni 41 par.6)=5€+18% TVSH= 5,90€** (pesë euro e 90/100)

Veprimi i noterizimit u krye në Lipjan, në selinë e Noterit Zyfer Aliu në adresën e larishëntuar.

NOTER

Zyfer Aliu

Arsyetimi e tretë për anulim që ka të bëjë me mos vërtetimin e para kontratës së Udhëheqësit të Punishtes në prani të punëdhënësit dhe punonjësit konstatojmë se kjo nuk qëndron dhe se është komplet arsyetim i pabazuar. Me vetë faktin se noteri e cekë se Para kontrata është përpiluar dhe nënshkruar nga pala duke i potencuar emrin e të dy nënshkruesve, dhe më vonë prapë e potencon se para kontrata e punës është nënshkruar para meje në selinë e zyrës sime personalisht nga pala është tregues i mjaftueshëm noterizimi i kësaj para-kontrate është bërë saktë sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe se arsyetimi i komisionit të vlerësimit është i pabazuar. Edhe arsyetimi se Udhëheqësi i Punishtes posedon vetëm një referencë nga lëmia e kërkuar e që në dosje janë kërkuar dy të tilla nuk qëndron sepse për udhëheqësin e punishtes kemi dorëzuar disa kontrata/refrenca saktë ashtu siç ishte kërkuar në dosje të tenderit. Në vazhdim po e paraqesim në formë vizuale aktin noterial dhe dy referenca sa për të dëshmuar se Komisioni i Vlerësimit ka dhëne arsyetim tendencioz dhe plotësisht të pa-bazuar ndërsa referencat tjera i gjeni në dosje të tenderit tonë.

Unë Sinan Visoka -Noter në Podujevë rr. Nuhi Gashi p.nr., Podujevë ----------

VËRTETOJ SE nënshkrimi i vënë në aktin:----------
PARAKONTRATE PUNE : përpiluar dhe nënshkruar nga pala:----------
VIA EGNATIA SHPK,me nru.810852930,me seli në Prishtinë,rr.Mustafë Veselaj,p.nr ,me pronar Z.GENC MUÇOLLI i lindur me datë 15/08/1992(Pesëmbëdhjetë Gusht Njëmijë enëntëqind enëntëdhjetëedy), në Prishtinë , me vendbanim në Prishtinë,rr.Esat Mekuli,p.nr , shtetas i Kosovës, bartës i letërnjoftimit me numër personal: 1500406379 , lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, me datë 03.01.2020 valid deri me datë 02.01.2030 ,të cilin e përfaqëson me autorizimin numër 2084/2020 ref.nr.501/2020 1 dates 08.03.2021 Skender Muçolli I lindur me datë 25/04/1949 në fshatin Bajçinë Komuna Podujevë ,I identifikuar me letërnjoftimin me numër personal 1011135451 dhe Z.SHEMSEDIN LATIFI i lindur me datë 15/03/1953 (Pesëmbëdhjetë Mars Njëmijë enëntëqind e pesëdhjetë e tre), në fshatin Bradash Komuna Podujevë , me vendbanim në Podujevë,rr.Haklf Zejnullahu ,p.nr , shtetas i Kosovës, bartës i letërnjoftimit me numër personal: 1014635765 , lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, me datë 05.07.2019 valid deri me datë 04.07.2029 ----------
Akti PARAKONTRATE PUNE është nënshkruar para meje në selinë e zyrës sime nga pala–personalisht, ndërsa është hartuar jashtë zyrës sime ----------
Noteri vërteton se nënshkrimi i palës është i vërtetë dhe është nënshkruar në prezencën time.----------
Bazuar në Ligjin mbi Noterinë, Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti.----------
Shpërblimi për punën e Noterit është llogaritur 1€ plus TVSH 18% + 1 kopje në bazë të numrit tarifor 8 dhe është në shumë sipas tarifës së noterëve, është përpiluar në Podujevë më 03.03.2022----------

---

DEPERTAMENTI I PROKURIMIT
z. Ibrahim Hoxha, menaxher
16/07/2014

Për: Shemsedin Latifi inxh.dipl.ndërt.

REFERENCË

Shemsedin Latifi, inxh. i dipl. i ndërt. i ka kryer me sukses punët në mbikëqyrjen e projektit:

Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në territorin e Komunës së Podujevës, gjatë sezonit dimëror 2012/3013.

Kontrata nr.61512152221 datë 03.12.2012.

Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë 1.789.65€. (Çmim diferi).

Punët në mbikëqyrjet e këtij Projekti e ka kryer me sukses dhe profesionalizëm të duhur sipas kritereve,kushteve dhe standardeve të parapara me Kontratë.

Konsiderojmë se, ky inxhinier ka aftësi menagjeriale,organizative dhe profesionale për mbikëqyrjen e Kontratave të kësaj natyre, prandaj e preferojmë te Punëdhënësit tjerë.

REFERENCE

Me kete leter Reference, z. SHEMSEDIN LATIFI, ing. dipl. i ndertimtarisë ne cilesin e udhëheqit të punishtes ka kryc te gjitha detyrat e kontrates:

MIRËMBAJTJA RUTINORE DHE DIMËRORE E AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) e A6 nga udhëkryqi A7/A6 deri në kyqjen në Konjuh dhe rrugën Nacionale N9, Pjesa 2 ,per perludhen kohore 03.07.2019 deri 03.07.2020 (viti i pare i ekzekutimit). Shuma e punimeve të realizuara është 1,477,640.55 euro.

Gjatë realizimit të kontrtes se larte cekur z. SHEMSEDIN LATIFI, ing. dipl. i ndertimtarisë me aftësi ka arrijtë ti realizoj te gjitha detyrat profesionale me integritet dhe pergjegjesi te larte ne pune.
Kjo reference leshohet per te deshmuar pervojen professionale nga famija e inxhinjorisë se ndertimit.

Prishtinë , 14.7.2020.

VIA EGNATIA" SH.P.K.
Drejtor Ligjore:Genc MUÇOLLI

Pra bazuar në aktin noterial dhe bazuar në dy referencat e paraqitura si dhe në referenca të tjera të ngarkuara në tenderin tonë shihet hapur se arsyetimi i tillë i Komisionit të Vlerësimit dhe AK-së në përgjithësi është plotësisht e pabazuar, tendencioz dhe antiligjorë.

Arsyetimi i katërt për anulim i Komisionit të Vlerësimit i cili ka të bëjë me kontratën e noterizuar të Inxhinierit të Diplomuar të Komunikacionit dhe ku thuhet se gjoja nuk është e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punonjësit si dhe qenka e hartuar jashtë zyrës noteriale është plotësisht tendencioze dhe antiligjore. Kërkesa ka qenë që kontrata të jetë e noterizuar në prani të punonjësit dhe punëdhënësit dhe saktë ashtu është edhe e dorëzuar. Me vetë faktin që noteri e cekë se Para kontrata është përpiluar dhe nënshkruar nga pala duke i potencuar emrin e të dy nënshkruesve, dhe më vonë prapë e potencon se para kontrata e punës është nënshkruar para meje në selinë e zyrës sime personalisht nga pala është tregues i mjaftueshëm noterizimi i kësaj para kontrate është bërë saktë sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe se arsyetimi i komisionit të vlerësimit është i pabazuar dhe shumë tendencioz. Edhe elementi i cekur si mangësi nga komisioni i vlerësimit se gjoja kontrata është bërë jashtë zyrës noteriale, sipas kërkesës së dosjes së tenderit nuk ka qenë fare si kërkesë andaj aplikimi i këtij kriteri konsiderojmë se është plotësisht në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së. Noteri e cek qartë se kontrata është përpiluar jashtë zyrës noteriale por që është e vërtetuar në prani të tijë. Pra kërkesa ka qenë vetëm për noterizimi në prani të noterit por jo edhe përpilimi. Për t'u bindur vet AK-ja se ky arsyetim është në kundërshtim me ligjin dhe me gjendjen reale të tenderit tonë, mjafton të sheh kërkesën e dosjes së tenderit dhe aktin noterial të bashkangjitur këtu por edhe në tenderin tonë që ndodhet së bashku me kontratën.

Unë Sinan Visoka –Noter në Podujevë rr. Nuhi Gashi p.nr., Podujevë ----------

VËRTETOJ SE nënshkrimi i vënë në aktin:----------
PARAKONTRATE PUNE : përpiluar dhe nënshkruar nga pala:----------
VIA EGNATIA SHPK.me nru.810852930,me seli në Prishtinë,rr.Mustafë Veselaj,p.nr ,me pronar Z.GENC MUÇOLLI i lindur me datë 15/08/1992(Pesëmbëdhjetë Gusht Njëmijë enëntëqind enëntëdhjetëedy), në Prishtinë , me vendbanim në Prishtinë,rr.Esat Mekuli,p.nr , shtetas i Kosovës, bartës i letërnjoftimit me numër personal: 1500406379 , lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, me datë 03.01.2020 valid deri me datë 02.01.2030 ,të cilin e përfaqëson me autorizimin numër 2084/2020 ref.nr.501/2020 i dates 08.03.2021 Skender Muçolli i lindur me datë 25/04/1949 në fshatin Bajçinë Komuna Podujevë ,I identifikuar me letërnjoftimin me numër personal.1011135451 dhe Z.MERITON RRAHIMI i lindur me datë 15/09/1986 (Pesëmbëdhjetë Shtator Njëmijë enëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë), në Podujevë , me vendbanim në Podujevë,rr.Xhemajl Mustafa,p.nr , shtetas i Kosovës, bartës i letërnjoftimit me numër personal: 1174707452 , lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, me datë 07.02.2014 valid deri me datë 06.02.2024 ----------
Akti PARAKONTRATE PUNE është nënshkruar para meje në selinë e zyrës sime nga pala–personalisht, ndërsa është hartuar jashtë zyrës sime ----------
Noteri vërteton se nënshkrimi i palës është i vërtetë dhe është nënshkruar në prezencën time.----------
Bazuar në Ligjin mbi Noterinë, Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti.----------
Shpërblimi për punën e Noterit është llogaritur 1€ plus TVSH 18% + 1 kopje në bazë të numrit tarifor 8 dhe është në shumë sipas tarifës së noterëve, është përpiluar në Podujevë më 03.03.2022----------

Për të ju sqaruar se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së dhe që ka aplikuar ligjin në mënyrë selektive, po ju paraqesim një akt noterial të fituesit nga Loti 2 që AK e ka shpallë fitues i cili është identik me atë që neve a e konteston komisioni i Vlerësimit:

Unë Sinan Visoka –Noter në Podujevë rr. Nuhi Gashi p.nr., Podujevë ----------

VËRTETOJ SE nënshkrimi i vënë në aktin:----------
MARREVESHJE PER FURNIZIM ME BETON : përpiluar dhe nënshkruar nga pala:----------
2 A Group " SH.P.K., me seli në Hyzri Talla Qendra Tregtare Bregu i Diellit - Prishtinë, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrim të Biznesit me numër unik identifikues 810846800 ,e cila përfaqësohet nga pronari z. VALON ADEMI i lindur në Prishtinë , me datë 11/07/1987 (Njëmbëdhjetë Korrik Njëmijë e nëntëqindetetëdhjetëeshtatë), shtetas kosovar , identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me nr.personal 1171934687, lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës,me datë 24.07.2014 valid deri me datë 23.07.2024 dhe NTSH DINO SHPK ., me seli në Konjuh-Lipjan , e regjistruar në Agjencinë për Regjistrim të Biznesit me numër unik identifikues 811272343 ,e cila përfaqësohet nga pronari z. RAMADAN SALIHU i lindur në Lipjan , me datë 10/07/1983 (Dhjetë Korrik Njëmijë e nëntëqindetetëdhjetëe tre), shtetas kosovar , identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me nr.personal 1010719409, lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës,me datë 21.03.2017 valid deri me datë 20.03.2027.----------
Akti MARREVESHJE PER FURNIZIM ME BETON është nënshkruar para meje në selinë e zyrës sime nga pala–personalisht, ndërsa është hartuar jashtë zyrës sime ----------
Noteri vërteton se nënshkrimi i palës është i vërtetë dhe është nënshkruar në prezencën time.----------
Bazuar në Ligjin mbi Noterinë, Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti.----------
Shpërblimi për punën e Noterit është llogaritur 1€ plus TVSH 18% + 1 kopje në bazë të numrit tarifor 8 dhe është në shumë sipas tarifës së noterëve, është përpiluar në Podujevë më 08.03.2022----------

Arsyetimi i pestë për anulim i komisionit të vlerësimit për gjoja mos plotësim nga ana jonë e kriterit lidhur me vlerën e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit në vlerat e cekura në kërkesë është plotësisht i pabazuar dhe pak sa edhe i çuditshëm. Në listën e kontratave të realizuara ne kemi paraqitur kontratat e ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit të cilat arrijnë vlerën prej 5,055,578.84€. AK ka konstatua se vlera e kontratave të prezantuara nga ne arrin shumën prej 1,840,000.00€ vlerë të cilën nuk e ka sqaruar askund se si e ka llogaritur. Në dosjen e tenderit kërkesa lidhur me projektet e realizuara ka qenë përcaktuar kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**4.Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e Mirëmbajtjes , te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale, për periudhën e shkuar tre vjeçare (2019, 2020 dhe 2021) jo më pak se** **Llot 1 = 5,400,000.00 €** **Llot 2 = 4,500,000.00 €** **Llot 3 = 3,000,000.00 €** **Llot 4 = 3,300,000.00 €** **Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e Mirëmbajtjes, te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale.**	**Deshmija 4. Kopje te kontratave dhe Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e Mirëmbajtjes, per periudhën e shkuar tre vjeçare, kontratat e sektorit privat duhet te jene te shoqruara me referenca dhe proqesverbale te pranimit te punëve.**

Në vazhdim po e paraqesim edhe listën e kontratave, ndërsa kontratat, referencat dhe raportet e pranimit përfundimtarë të projekteve të realizuara nga ne në bashkëpunim me OE tjerë si **Grup i OE** i gjeni në tenderin tonë.
AK si duket(*hamendësojmë*) ka bërë ndarje të vlerës së projekteve të realizuara sipas numrit të anëtarëve të konzorciumit mirëpo nëse e ka bërë këtë del që ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së dhe nuk ka respektuar as kërkesën që vet e ka vendosur në dosjen e tenderit. Tek Kërkesa e dosjes së tenderit askund nuk thuhet se referencat do të kalkulohen duke i u atribuuar vlerë të caktuar liderit apo edhe anëtarëve të konzorciumit. Me vet faktin që kriteret e paraqitura sipas nenit 69 të LPP-së lidhur me projektet e realizuara aplikohen vetëm ndaj Grupit të OE e jo ndaj secilit anëtar të konzorciumit nënkupton se referencat e tilla duhet të konsiderohen si të plota dhe të pranohen saktë ashtu siç i kemi paraqitur ne në listën e tillë. Këtë e thotë qartë pika 4 e nenit 71 të LPP-së e cila e potencon kështu:

> 71.4 Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obligüar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Sipas kësaj shihet qartë se referenca kundrejt kërkesës së dosjes së tenderit duhet të merret si e plotë dhe jo të ndahet siç ka vepruar Komisioni i Vlerësimit.
Ja edhe lista e kontratave që ne kemi paraqitur në tenderin tonë e që janë të dëshmuara edhe me kontrata, referenca dhe raporte përfundimtare të pranimeve teknike.

LISTA E KONTRATAVE të REALIZUARA

për vitet 2019, 2020 dhe 2021

nr.	Investitori	Kontraktori	Kontrata	Vlera e realizuar	Data e realizimit	Natyra	Vendi
1	Ministria e Infrastrukturës	Damastion & Via Egnatia	Mirëmbajtja rutinore dhe dimerore e Autoudhes A6 (Arber Xhaferi – Segmenti Konjuh-Doganaj,L-32.82km(për vitin 2019 dhe 2020)	1,039,976.95	20.3.2020	Mirëmbajtje e rrugve	Kosovë
2	Ministria e Infrastrukturës	Damastion & Via Egnatia	MIRËMBAJTJEN RUTINORE DHE DIMERORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) e A6 nga udhëkryqi A7/A6 deri në kyçjen në Konjuh dhe rrugën Nacionale N9, Pjesa 2 (për vitin 2019 dhe 2020)	1,477,640.55	9.7.2020	Mirëmbajtje e rrugve	Kosovë
3	Ministria e Infrastrukturës	Damastion & Via Egnatia	Mirëmbajtja rutinore dhe dimerore e Autoudhes A6 (Arber Xhaferi – Segmenti : Konjuh-Doganaj,L-32.82km(për vitin 2020 dhe 2021)	1,024,085.62	15.3.2021	Mirëmbajtje e rrugve	Kosovë
4	Ministria e Infrastrukturës	Damastion & Via Egnatia	MIRËMBAJTJEN RUTINORE DHE DIMERORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) e A6 nga udhëkryqi A7/A6 deri në kyçjen ne Konjuh dhe rrugën Nacionale N9, Pjesa 2 (për vitin 2019 dhe 2020)	1,513,875.72	21.7.2021	Mirëmbajtje e rrugve	Kosovë
			SHUMA	5,055,578.84			

Bazuar në këtë dhe në sqarimet e ofruar shihet se AK tek tenderi jonë pa të drejtë ligjore ka paraqitur si mangësi sasinë e projekteve të realizuara në tre vitet e shkuara. Sipas dëshmive që kemi paraqitur në tenderin tonë dhe sipas arsyetimit të paraqitur në këtë pretendim shihet se arsyetimi i komisionit është i pa bazuar dhe se kriterin e tillë të AK-së ne e kemi plotësuar saktë ashtu siç edhe ishte kërkuar.

Arsyetimi i gjashtë për anulim i komisionit të vlerësimit për gjoja mos dorëzim të specifikimeve teknike sipas FTD-së është plotësisht i kundërligjshëm që bie ndesh me nenin 59.4 të LPP-së. Ky kriter nuk ka qenë i përcaktuar në dosjen e tenderit pra në Fletën e të Dhënave të Tenderit dhe se si i tillë nuk lejohet të aplikohet gjatë vlerësimit të tenderëve pasi që këtë e ndalon edhe neni 56.3 i LPP-së. Ne i kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë që tregojnë se jemi në pajtueshmëri me termet e referencave dhe kërkesat e përcaktuara që duhet të plotësohen nga OE në këto dy dokumente por që dorëzimi i tyre nuk është kërkuar. Mandatore për dorëzim sipas LPP-së janë vetëm dokumentet e përcaktuara tek FTD-ja e që sipas kësaj të fundit kërkesa për dorëzim të specifikimeve teknike

nuk ka qenë pjesë e sajë. Nga kjo shihet se thirrja e komisionit të vlerësimit tek arsyetimi për gjoja nuk e kemi dorëzuar specifikimin teknik sipas Seksionit II. Fleta e të Dhënave të Tenderit(FDT) Aneksi 1 është e padrejtë dhe i pabazuar sepse kjo nuk ka qenë e përcaktuar tek Fleta e të Dhënave të Tenderit. Shtrohet pyetja pse nuk është e nevojshme detyrimisht të dorëzohet Aneksi 1 nëse nuk është e përcaktuar si kërkesë tek Fleta e të Dhënave të Tenderit? Përgjigjja është se Aneksi 1 tek shërbimet është vetëm sa për ta informuar OE se si do të kryhen shërbimet dhe se me çka duhet të dëshmohet se OE është i përgatitur për kryerjen e shërbimeve të tilla. Këto dëshmi ne i kemi dorëzuar të gjitha dhe se tek formulari i tenderit ku edhe kemi dhënë ofertën e përfundimtare jemi deklaruar se:

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

Këtë deklaratë e kemi dhënë për të gjitha lotët andaj edhe plotësohet kushti që ne do t i përmbahemi dosjes së tenderit dhe kontratës që derivon nga kjo dosje gjatë tërë procesit të implementimit të kontratës. Sa për sqarim, as kontrata që ndodhet në dosje nuk dorëzohet nga OE por që të njëjtën detyrohen ta respektojnë të gjithë ata që hyjnë në kontratë pikërisht për shkak të deklaratës së mësipërme. Arsyeja tjetër është se pjesë e kontratës është edhe oferta e OE ku përmes dëshmive që kanë dal si detyrim nga FTD-ja dhe nga kërkesat tjera të dosjes tregohet se do të respektohet oferta e dhënë gjatë tërë periudhës kontraktuese.
Sipas kësaj që ofruam si sqarim shihet qartë se veprimi i komisionit vlerësues lidhur me atribuimin si mangësi mos dorëzimin e Aneksit 1 është vetëm një shkasë shtesë që përdoret me tendencë për të na eliminuar pa të drejtë, qëllimisht dhe detyrimisht nga konkurrenca.

Sipas krejt kësaj që e sqaruam më lartë lidhur me veprimet e komisionit të vlerësimit dhe gjendjen reale të dëshmive tona të kontestuara nga ky komision, shihet se veprimi i tyre është tendencioz, jo profesional dhe në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së si dhe në kundërshtim të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit të parapara nga vet AK-ja.

Në vazhdim do të paraqesim edhe veprimet antiligjore dhe favorizuese të këtij komisioni karshi dy Grupeve të OE të shpallur pa drejtësisht si fitues tek Lot 2 dhe tek Lot 4 si dhe mangësitë që këto dy Grupe të OE-ve posedojnë në tenderët e tyre.

Veprimet antiligjore të komisionit të vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderit të dorëzuar nga Grupi i OE "2A Group SH.P.K.; NNT ABCSH.P.K.; B CORP SH.P.K.; JUBICA shpk" e që e ka shpallur edhe fitues tek Lot 2 dhe mangësitë në tenderin e tijë janë:

AK nuk ka respektuar nenin 10 të LPP-së me rastin e qasjes tonë në dokumentet e tenderit pasi që tek tenderi i Grupit të OE **"2A Group SH.P.K.; NNT ABCSH.P.K.; B CORP SH.P.K.; JUBICA shpk"** pasi që në një pjesë të tyre nuk na ka dhënë qasje. Këtë e ka bërë duke u thirrur në deklaratën për sekret afarist sipas nenit 11 të LPP-së mirëpo kjo dihet se është bërë qëllimisht pasi që Grupi i OE në fjalë shumicën e pajisjeve i ka pa targa apo që nuk janë fare të regjistruara. Sipas nenit 11 dhe sipas interpretimit të KRPP-së AK duhet të përgatis versionin e pastruar të dëshmive dh etu jep qasje OE të interesuar. Jo çdo dokument që lidhte me nenin 68 dh e69 mundet me u

cilësua dhe pranua nga AK si konfidenciale. Vetëm një shembull të thjesht. Çfarë dëmtimi afarist mundet me shkaktua informata mbi regjistrimin e Traktorit IMT 539 përpos faktit që është paraqitu me 60 KF ndërsa dihet qartë se ai posedon vetëm 39 KF. Është paraqituri i paregjistruar ndërsa me ligj duhet të jetë i regjistruar. Pra kjo është shkelje e plotë e nenit 11 të LPP-së dhe fshehje e padrejtë e informatave lidhur me Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pasi që të gjitha ato dokumente janë publike dhe gjenden nëpër institucione të ndryshme.

Sipas hulumtimit tonë kemi vërejtur se:

- Tek pozicioni 5 është kërkuar Spërkatës bitumeni dh emulsioni ndërsa OE ka ofruar Makinë që nuk është e regjistruar ne targa dhe nuk posedon librezë qarkullimi të Republikës së Kosovës. Përderisa makina si kjo me shasi dhe boshte, duhet patjetër te jetë e regjistruar dhe të ketë librezë qarkullimi qe ti mundësohet lëvizja . Kjo bie ndesh me kërkesat e parapara nga AK ne dosjen e tenderit. WEIRO TM600SKH



- Tek pozicioni 7 është kërkuar kompresor ajri ndërsa OE në fjalë ka paraqitur 3 kompresor me shasi dhe boshte atëherë të njëjti edhe duhet të kenë librezën e qarkullimit. OE nuk ka ofruar dëshmi se këto pajisje janë të regjistruara.

ATLAS-COPCOM XAS50

- Tek pozicioni 8, OE ka paraqitur Kamionin me targa: 01-247-MK por i njëjti nuk posedon regjistrim valid.

- Tek pozicioni 14, AK ka kërkuar traktor me fuqi min. 60 KF me RIMORKIO. OE ka dorëzuar traktorin e gabuar sepse është I tipit: IMT 539 dhe dihet hapur se ky traktor posedon vetëm 39 KF. Traktori është në emër të Mehmet Visoka dhe nuk ka regjistrim valid.

- Rimorkio e ofertuar nga OE nuk është rimorkio traktori por është rimorkio KAMIONI apo ndonjë tip rimorkiosh tjera. RIMROKI ME TAGRA 01-156-XC nuk ekziston ne sistemin shtator të regjistrimeve dhe se kjo targë është fiktive. Posedon një sigurim por në një targë tjetër.

CELEMAN TRAILER



- Kërkesa minimale për Mirëmbajtën Dimërore tek rubrika 2. Automjetet transportuese(kamion) ne te cilën montohet borëheqësja(pllugjet) dhe shpërndarësit e kripës. OE ka paraqitur 12 kamion kishe për pastrimin e bores.

Në tabelën e më poshtme po paraqesim se si i kanë deklaruar OE e si janë në të vërtet në sistemin shtetëror të regjistrimeve.

DEKLARIMET SIMAS OE	DEKLARIMET NGA SISTEMI SHTETEROR KS DHE AL
1.01-205-SA,**B CORP SHPK**	NUK FIGURON NE FARE SISTEM
2. 01-251-MS, **B CORP SHPK**	NUK FIGURON FARE NE SISTEM A – ABC SHPK

3. 01-310-QS, **B CORP SHPK**	A–ABC SHPK komp. jashtë konzorciumit
4. 01-748-QI, **B CORP SHPK**	NUK FIGURON FARE NE SISTEM
5. 01-791-QO, **B CORP SHPK**	NUK FIGURON FARE NE SISTEM
6. 01-792-QO, **B CORP SHPK**	NUK FIGURON FARE NE SISTEM
7. 01-799-PA, **B CORP SHPK**	A–ABC SHPK komp. jashtë konzorciumit
.01-384-NT, **B CORP SHPK**	ABC SHPK, DHE NUK KA SIGURIM
10. 01-804-NP, N.N.T "ABC"	ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUC
11.AA 917 NZ	SIGURIMI NE RREGULL

Pra po shihet se të gjitha këto pajisje janë jo të rregullta dhe nuk janë të regjistruara në sistem ashtu siç janë deklaruar. Kjo tregon se KY grup i OE ofruar informata mashtrues dhe sipas nenit 65 të LPP-së por edhe sipas Kodit Penal të Kosovës konsiderohet vepër penale. Nisur nga kjo AK është dashur ta konsideroj si të papërgjegjshëm se ashtu është realisht.

Tek pozicioni 13 kërkesa ka qenë për Kamion vetëshkarkues kiper ndërsa OE ka deklaruar 2 kamion me targa: 01-804-OP dhe 01-805-OP. Këta kamion janë deklaruar se janë prone e OE 2A Group SH.P.K. mirëpo ne sistemin shtetëror të Republikës së Kosovës figurojnë se janë në pronësi te kompanisë **ALKO – IMPEX General Constuct.**

Makineritë në vazhdim të deklaruara nga Grupi i Operatoreve Ekonomik:
01-950-TA ,2A Group..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-150-XC, B CORP SHPK..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-751-QI, B CORP SHPK..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-751-QI, B CORP SHPK ..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-247-MK, NNT ABC SHPK..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-451-MM, 2A Group..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-748-OC, 2A Group..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-743-KK, 2A Group..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-967-QQ, ABC..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-156-XC,..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-438-NG,..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR
01-176-XC,..... NUK FIGURON NE FARE NE SISTEM SHTETNOR

Ky OE ka edhe shumë mangësi tjera tek kontratat, lista e stafit, tek marrëveshjet me OE tjerë, makineritë dhe marrëveshjet për shfrytëzim të tyre, tek noterizimet etj. por për shkak të afatit të shkurtër kohorë dhe në mungesë të shumë dokumenteve që nuk na i ka dhënë AK nuk kemi mundur të i përfshijmë të gjitha ato mangësi. Sipas analizave të bëra nga ne shihet se ky OE është plotësisht i papërgjegjshëm dhe se pa të drejtë AK e ka shpallur fitues duke anashkaluar kërkesat që vet i ka vendosur në dosjen e tenderit. Mangësitë e tilla dhe informatat me dëshmi mashtruese e bëjnë këtë Grup të OE përgjegjës për ofrimin e dëshmive të rrejshme e po ashtu edhe komisionin Vlerësues që nuk e ka marrur mundimin fare të i verifikoj por i ka pranuar si të rregullta. Shkeljet e tilla shtesë do të i paraqesim nëse AK nuk e aprovon kërkesën tonë për rishqyrtim dhe ne detyrohemi të parashtrojmë ankesë edhe pranë OSHP-së. Përpos kësaj nëse AK nuk merr masa ndaj këtyre shkeljeve atëherë ne do të i drejtohemi edhe organeve kompetente për ndjekje të rastit

si mashtrim dhe ofrim të dëshmive të rrejshme me qëllim përfitimi material në mënyrë të paligjshme.

Veprimet antiligjore të komisionit të vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderit të dorëzuar nga Grupi i OE "**Arbotec SH.P.K.; ARBOTEC GMBH - DEGA NË KOSOVË**" e që e ka shpallur edhe fitues tek Lot 2 si dhe mangësitë në tenderin e tijë janë:

- Menaxheri i projektit te kompanisë fituese për Lot 4 z. Burim Llullaku, nuk i ka të dëshmuara ne CV se ka përfunduar dy projekte nga lëmia e mirëmbajtjes. E ka të cekur vetëm një_kontratë, nga kjo kontratë kompania ia ka lëshuar dy referenca pra për secilin vit nga një. Kjo nuk është e lejuar me LPP andaj ky kusht nuk është plotësuar. Shihe CV-në dhe referencat!

- Akti noterial LRP 6780/2020 nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse e ka vërtetuar Kompania Arbotec për Burim Llullakun e që në dosje ka qenë e kërkuar të vërtetohet nga vet personi. Kjo konsiderohet mangësi.

- Akti noterial LRP 6782/2020 - Referenca nga Menti export-import nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse e ka vërtetuar z. Adnan Hajdari në emër të Burim Llulakut ndërsa në dosje ka qenë e kërkuar të vërtetohet nga vet personi. Kjo konsiderohet mangësi.

- Tek CV e Udhëheqësit të Punishtes, z. Urim Kastrati shihet se data e CV është 2022-2019 ndërsa vërtetimi tek noteri është bërë nga Adnan Hajdini sipas aktit noterial LRP: 2014/2021 dhe se gjatë këtij akti nuk e ka prezantuar fare origjinalin e diplomës por të njëjtin veprim e ka kryer me kopje të diplomës.

- Referencat e udhëheqësit te punishtes nuk janë të dëshmuara me Proces Verbale të pranimit teknik.

- Ne referencën e kompanisë nuk figuron fare projekti i dyte i udhëheqësit të punishtes por vetëm kontrata me numër 58/2014 Prishtina 1. Mungon edhe proces verbali dhe pranimi teknik.

- Kontrata me kompaninë Bageri lidhur me marrjen me qera te pajisjeve sipas LPR : 2110/2022 tregon se Validiteti i kontratës është 1 vjet e 6muaj për saktësisht 18 muaj e që sipas kërkesës është dashur të jetë 36 muaj. Kjo tregon qe kontrata në fjalë është e papranueshme dhe kushti për makinerinë nuk është plotësuar. Shihe aktin noterial:

----------Neni 3 ----------

3.1 Kontrata mbi qiranë sipas marrëveshjes së palëve do të zgjasë 1 vit e gjashtë muaj përkatësisht

Faqja2

18 muaj (një vit e gjashtë muaj përkatësisht tetëmbëdhjetë muaj) dhe ate duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës , perkatesisht gjerë ne skadimin e kontrates per sherbimet me autoritetin kontraktues dhe ate me mundësi vazhdimi edhe për një periudhe te caktuar kohore sipas nevojave

Faturat dhe paragonat me të cilat dëshmohet blerja nuk e kanë procesin e pagesës bankare apo konfirmimin bankarë dhe si të tilla nuk janë të pranueshme e që e dëshmon edhe më shumë se kjo kantatë nuk duhej pranuar si e rregullltë.

- Tek akti noterial i kontratës me LRP 2095/2022 është mangësi e njëjtë tek afati i kontratës sikurse tek pretendimi i mësipërme për aktin noterial LRP 2110/2022. Sipas ligjit për pagesa të ATK-së, në Kosovës të gjitha faturat mbi vlerën 500 euro duhet të bëhen përmes bankës andaj mungesa e dëshmisë bankare për blerjet e makinerive i bënë këto dy dëshmi mbi kontratat për marrje me qira të makinerive të pa vlefshme dhe si të tilla nuk e plotësojnë kushtin ligjorë të kërkesës së dosjes së tenderit.

- Sipas aktit noterial LRP 2200/2022 shihet se marrëveshja për furnizimi me asfalt nga KOSOVA ASFALT është pa validitet dhe si e tillë është e papranueshme. Kriteri i dosjes së tenderit për posedim të bazës së asfaltit konsiderohet i papranueshëm dhe ky Grup i OE konsiderohet i papërgjegjshëm.

- Plani i menaxhimit, veprimit dhe shpërndarjes së kripës sipas specifikacionit teknik është kërkuar që koha maksimale nuk duhet të jetë më shumë se 2 orë ndërsa ky Grup i OE nuk e ka cekur askund se sa do të jetë ajo kohë. Sipas kësaj konsiderohet kusht i paplotësuar.

Lista e makinerive en-minutes ARBOTEC SHPK ka shumë mangësi dhe të njëjtat po i renditim më poshtë:

- Është kërkuar **cilindër vibrues** me peshë 7-12t, OE e ka paraqitu dudin doganor me nr:19081. Ndërsa sipas gjetjeve tona DUDI DOGANOR ORIGJINAL posedon numrin 190082. Kjo konsiderohet dokument i pa vlerë dhe ky kusht nuk konsiderohet i plotësuar.

- Është kërkuar **cilindër vibrues** me peshë 3-5t, ndërsa është dorëzuar cilindër vibrues me 2.67t sepse kur bëjmë hulumtim sipas faturës SIK 0002108 dhe tipit: COMPACTOR, CB224E del të jetë me peshë 2.67t. Kjo shihet në katalogun e këtij tipi të cilindrit.

- Për **Spërkatësen e bitumonit dhe emulsionit** si dhe për **prerësen e asfaltit** nuk ka dëshmi mbi prejardhjen e tyre, pra nuk ka dëshmi mbi pagesën e kryer po vetëm fatura fiktive. Kjo konsiderohet mos plotësim i kërkesave nga dosja e tenderit.

- **Kompresori i ajrit** në dudin doganor përshkruhet si mjet me 2 rrota mbi një shasi andaj sipas ligjit për komunikacionin dhe automjetet, ku mjet duhet të jetë i regjistruar dhe të posedoj Librezë Qarkullimi si gjysëm rimorkio – kompresor ajri. OE e ka paraqitur vetëm dudin doganor pa regjistrim të Republikës së Kosovës. Mjeti i paraqitur ne fjalë duhet patjetër të jetë i regjistruar sepse është shasi me dy rrota. SHIF FIGUREN si shembull i gjysme rimorkios dhe i librezës së regjistrimit që këtij mjeti i mungon. Edhe kjo konsiderohet mangësi dhe për këtë ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm.



- Tek pozicioni 10 AK ka kërkuar 2 copë - **PICK UP – KAMIONETA**. OE ka paraqitur **FURGON** 01-876-OK, **FURGON** 01-890-OK të cilët nuk e plotësojnë kriterin e tipit të automjetit të kërkuar dhe si të tilla nuk pranohen.

- Tek **pozicioni 11** OE nuk ka paraqitur dëshmi mbi pagesën e kryer me bankë por vetëm fatura fiktive.

- Tek pozicioni 14 AK ka kërkuar **RIMORKIO** ndërsa OE ka ofruar gjysmë rimorkio bujqësore me targa 01-291-TA, qe bie ndesh me kërkesat e AK-së dhe automatikisht nuk e plotëson kriterin e tillë për çka është dashur të konsiderohet i papërgjegjshëm.

- Tek **pozicioni 16** OE nuk ka ofruar dëshmi mbi pagesën bankare por vetëm fatura fiktive.

- Tek pozicioni 17 AK ka kërkuar Automjet me fshirëse **automatike për pastrimin e** 1. shtresës qarkulluese, 2. rigollave dhe ***3. pahive elastike.*** OE ka dorëzuar 2 makineri për pastrimin: 1. rigollave, 2. shtresës qarkulluese dhe nuk ka dorëzuar për PAHI ELASTIKE sepse fshesa automatike për pastrimin e pahive elastike janë furqa speciale për pastrimin e pahive elastike dhe shenjave të trafikut që dirigjohen nga automjete speciale me kordon. Shih figurën për sqarim. Makineritë me targa: 01-659-JQ dhe 01-798-MS që OE i

ka dorëzuar nuk posedojnë dhe të njëjtave nuk mundet të i vendosen këto lloje të furqave. Vlen te potencohet se këto dy furqa të paraqitura ne figure për pahi dhe shenja trafiku duhen te kenë Dudin Doganor, te cilin OE ARBOTEC SHPK nuk e ka paraqitur fare. Kjo dmth qe kjo kërkesë nuk është plotësuar andaj OE në fjalë është i papërgjegjshëm.






Pajisjet Dimërore:

- Tek pozicioni 4 AK ka kërkuar **2 kamion vetëshkarkues** **deri në 12t**, ndërsa OE ka paraqitur 2 kamion vetëshkarkues të cilët e kalojnë peshën e 12t. 07-647-CF me17.969t sipas librezës dhe 07-977-DM me peshë 13.820t sipas librezës së qarkullimit

- Tek **pozicioni 5** OE nuk ka ofruar dëshmi se e ka bërë pagesën me bankë siç kërkohet me ligjin e ATK-së për pagesat mbi vlerën 500€. Dmth ka dorëzuar vetëm fatura fiktive.

- Tek **pozicioni 6** në listën e pajisjeve OE ka deklaruar faturën për mjetin e kërkuar nga AK por nuk e ka paraqitur si dëshmi andaj konsiderohet mos plotësim i pozicionit përkatës.

Ky OE ka edhe shumë mangësi tjera tek kontratat, lista e stafit, tek marrëveshjet me OE tjerë, makineritë dhe marrëveshjet për shfrytëzim të tyre, tek noterizimet etj. por për shkak të afatit të shkurtër kohorë nuk po mundemi me i përfshi të gjitha. Sipas analizave të bëra nga ne shihet se ky OE është plotësisht i papërgjegjshëm dhe se pa të drejtë AK e ka shpallur fitues duke anashkaluar kërkesat që vet i ka vendosur në dosjen e tenderit. Shkeljet e tilla shtesë do të i paraqesim nëse AK nuk e aprovon kërkesën tonë për rishqyrtim dhe ne detyrohemi të parashtrojmë ankesë edhe pranë OSHP-së.

Pas gjithë kësaj analize dhe vërejtjeve të dhëna, konstatojmë se nuk është bërë vlerësimi i drejtë i tenderëve nga ana e AK-së përkatësisht nga ana e Komisionit të Vlerësimit pasi që ne eliminohemi edhe përkundër plotësimit të të gjitha kushteve të Dosjes së Tenderit ndërsa Grupi i OE "2A Group SH.P.K.; NNT ABCSH.P.K.; B CORP SH.P.K.; JUBICA shpk." që ka shumë mangësi dhe posedon çmimin shumë më të lartë se ne shpallet fitues. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e nenit 59 të LPP që ka të bëjë me vlerësimit e tenderëve sipas kritereve dhe kërkesave të parapara ne dosjen e tenderit.

AK përkatësisht komisioni i vlerësimit ka vepruar njëjtë edhe për Grupi e OE "Arbotec SH.P.K.; ARBOTEC GMBH - DEGA NË KOSOVË" ku edhe përkundër shumë mangësive në tenderin e tijë, e shpallë fitues në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së dhe në kundërshtim të plotë me kriteret dhe kërkesat e parapara në dosjen e tenderit.

Veprimi i tillë i AK-së përkatësisht veprimi i Komisioni të Vlerësimit konsiderohet shkelje e plotë e **nenit 59 të LPP**-së si dhe shkelje e të gjitha dispozitave të ligjit që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e drejtë të tenderëve duke u bazuar vetëm në kërkesat e parapara në dosjen e tenderit.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me LPP-në dhe si pasojë e kësaj ka shpërblyer me kontrata OE që janë të papërgjegjshëm dhe se posedojnë edhe çmimin shumë më të lartë se ne. Kjo konsiderohet shkelje edhe e kriterit të vlerësimit i vendosur në përputhje me nenin 60 të LPP-së e që është **Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat e projekti. AK ka vendosur shumë kritere dhe kërkesa që lidheshin me nenin 69.6 të LPP-së por që asnjëherë nga këto kritere nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Shumicën e këtyre kritereve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderëve të shpallur fitues tek Lot 2 dhe Lot 4 ndërsa të njëjtat kritere i ka keq aplikuar dhe i ka keqinterpretuar kur bëri vlerësimin e tenderit tonë. Këtu përpos që kemi të bëjmë e mos aplikim të drejtë të kritereve te dosjes dhe kërkesave të nenit 69.6 të LPP-së, kemi të bëjmë edhe me favorizim të grupeve të OE të shpallura fitues dhe me diskriminim të grupit tonë si tenderues i përgjegjshëm me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Pretendimi 7: AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së pasi që akoma nuk ka kthyer përgjigje lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim që ne e kemi dorëzuar me datë 27.04.2022. Pika 6 e këtij neni shumë qartë e tregon se:

> 6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Ne nuk kemi pranuar asnjë njoftim për afat shtesë e as përgjigje nga AK andaj bazuar në këtë ne jemi detyruar që të i drejtohemi OSHP-së me ankesë për shkeljet e pretenduara që AK i ka bërë gjatë procedurës së vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Me këtë konstatohet se AK ka shkelur nenin 108/A pasi që nuk ka kthyer përgjigje në Kërkesë për Rishqyrtim brenda afateve të përcaktuara nga nenin përkatës i LPP-së.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit të OE **"VIA EGNATIA SH.P.K. & GASHI ING SH.P.K & HUMOLLI-S - PETROL SH.P.K. & VJV GROUP L.L.C."** lidhur me tenderin **"1. MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) LLOT 1 DHE LLOT 2 dhe 2. MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A6 (ARBËR XHAFERI) LLOT 3 DHE LLOT 4" për Lot 2 dhe Lot 4** i iniciuar nga **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS.**

ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK - **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS** për **Lot 2** dhe **Lot 4,** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të LPP-së ku më pas do duhej që për njërin nga Lot-et, **Fitues** të shpallej OE **"VIA EGNATIA SH.P.K. & GASHI INGSH.P.K & HUMOLLI-S - PETROL SH.P.K. & VJV GROUP L.L.C."**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë.

143/22

Neni 59–Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve **Neni 60-Kriteret për dhënie të kontratën** **Neni 69- Aftësia teknike dhe ose profesionale** **Neni 108/A ,paragrafi 6 - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

SALLAHU

Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

VËRTETIM TATIMOR
TAX VERIFICATION
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosova certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova ovorava da dolje identifikacono lice:

1000871300

Emri i personit: / Name of Person: / Ime lice:	Companya Eskavatori SH.P.K.
Numri Identifikues Personal: / Personal Identification Number: / Identifikacioni LIRoI Broj:	1012450903
Numri Fiskal: / Fiscal Number: / Fiskalni Broj:	810646169
Komuna: / Municipality: / Opština:	FERIZAJ
Data: / Date: / Datum:	01.03.2022
Arsyeja e lëshimit: / Reasoning: / Razlog izdavanja:	Aplikim për Tender

Ka këtë gjendje tatimore në ATK
Has the following tax position with the TAK:
Ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore.
This person is registered with TAK and has no current outstanding tax debts or other obligations.
Lice je registrovano u PAK i nema aktuelne nelsplačene poreske dugove ili drugih poreskih obaveza

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, megjithë, ky vërtetim nuk përfshinë obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK ovorava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova podvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda važi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -
Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uvoravati i linku:
https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer

Hr.Formë VT - 2; Koeficiu n.5 30.04.2013

Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo
Qeveria • Vlada • Government
Ministria e Financave • Ministarstvo Finansija • Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës • Poreska Administracija Kosova • Tax Administration of Kosovo

VËRTETIM TATIMOR
TAX VERIFICATION
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës vërtetohet se personi fiskalisht i njohur me poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the personal identified below:
Poreska Administracija Kosova u ovom da dokaže identifikacioni broj:

1000869317

Emri i personit: / Name of Person: / Ime lice:	Damastion Project SH.P.K.
Numri Identifikues Personal: / Personal Identification Number: / Identifikacioni i Poslovnog:	
Numri Fiskal: / Fiscal Number: / Fiskalni Broj:	810499956
Komuna: / Municipality: / Opština:	PRISHTINË
Data: / Date: / Datum:	23.02.2022
Arsyja e Leshimit: / Reason(s): / Razlog Izdavanja:	Aplikim për Transfer

ka kërkë gjendje tatimore me ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresku poziciju u PAK:

Personi fiskal i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore.

ATK vërtetoi se informatat e dhëna janë të saktë dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, megjithëkëto, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK uverava da su date informacije tačne i potpune na dan ovog potvrde, ali ova potvrda ne isključuje poreske obaveze koje mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda važi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun:
Verification of this tax verification, you can do on the link: • Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uvesti i linku
https://aVertetim.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer

- Ndërsa , për Lot 1 , operatori **Lika Company Sh.p.k : Lika Trade Sh.p.k " duhet të shpallet i pa përgjegjshëm dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit sepse :**

1.Tek lista e paisjeve :
Pikat : 1.1 , 1.2 , 1.3 , 1.4 , 1.5
Nuk i plotëson këto pika, për faktin se ;

Ka ofruar një situacion, përkatësisht disa skica me disa objekte ,ku si deshmi ka ofruar nje Flete Poseduese dhe Kopje te Planit , te cilen ne ate flete poseduese , kinse jane te vendosura keto skica , ku Lloji i njesise eshte Parcele , dhe Shfrytezimi aktual eshte Bujqësore-Ara. Pra nuk kemi te bejme me Parcele Ndertimore, me cka mund te konkludohet se nderimet tilla nuk jane te lejuarat e behen ne parcelat bujqesore-ara.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA /PERSON : Lika Company SH.P.K.

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	14-942-35042
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	30.12.2021 - 15:45
Komuna / Opština / Municipality:	FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE / FUSHE KOSOVE
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE / FUSHE KOSOVE

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i shoqërisë (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime Firm Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shtetësia/ shtetësitë ose regjistrimit Državno državljanstvo ili okruženja Country citizenship	Datëlindja/Data e themelimit Rođendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar me datën Urađeno na dan Created On	Azhurnuar Ažurirano Updated
Lika Company SH.P.K.			/ /	811593565	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO	15.03.2021	03.06.2021	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhurnuar Ažurirano Updated
FUSHE KOSOVE / KOSOVO POLJE / FUSHE KOSOVE		Mirudi e Ulët Ruga Zona industriale, p.n	Mirudi e Ulët Ruga Zona industriale, p.n	

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Ejup.Gerguri [Personi/Osoba/Person: Lika Company SH.P.K.]

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person:

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Kat/ Et Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i ngjarjes Zona mesta Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kulturë-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-72514027-00528-0	FUSHË KOSOVË / KOSOVO POLJE / FUSHE KOSOVE	Miradi E Poshtme / Donje Dobrevo / Miradi E Poshtme	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land / R		LATKOVICA / LATKOVICA / LATKOVICA	23640	Shfrytëzim - Arat - Arë E Klasës 2 / Shfrytëzim - Arat - Arë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 2 Klase / Poljoprivredno - Njive - Njiva 3 Klase / / Agriculture - Arable - 2nd Class Arable Land / Agriculture - Arable - 3rd Class Arable Land / /	1/1	Posedim individual / Individualna Državina / Single possesion	03.06.2021

C. HIPOTEKA - HIPOTEKA - MORTGAGE

Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Nr i NJësisë kadastrale Br. Katastarske jedinice Cadastral Unit no	Zona Kadastrale Katastarska Zona Cadastral Zone	Personi/Njësi Zalogoprimac Mortgage	Përshkrimi Opis Description	Afati i skadimit Rok isteka Due date	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)	Prioriteti Prioritet Priority	Azhurnuar Ažurirano Updated
Hipoteka / Hipoteka / Mortgage	P-72514027-00528-0	Miradi E Poshtme / Donje Dobrevo / Miradi E Poshtme	NLB Banka SHA.	" Kontrata Kornizë Për Limit të Produktevë Kredimeve Për Biznes " Nr. 111-2306-21, të datës 23.06.2021.	23.06.2031	23640	1	12.07.2021
Hipoteka / Hipoteka / Mortgage	P-72514027-00528-0	Miradi E Poshtme / Donje Dobrevo / Miradi E Poshtme	NLB Banka SHA.	" Kontrata Kornizë Për Limit të Produktevë Kredimeve Për Biznes " Nr. 111-2306-21, të datës 23.06.2021.	23.06.2031	23640	1	12.07.2021

Ne baze te sasive indikative te llogaritura per LOT I vlera e ofertes se OE Lika eshte 3,955,767.00 dhe jo sikurse e ka vendosur AK 3,838,169.79 euro.
Pra 117,597.00 euro diference.

Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit dhe rekomandimit per kontrate te nje operatori te pa pergjegjshem dhe me çmimin me te te shtrenjte ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e meposhtme te LPP-së, dhe rregullave te tjera per prokurim publik :
Neni 7- Barazia në trajtim/Jo-Diskriminimi , Neni 27-Dosja e tenderit,Neni 28-Specifikimet teknike,Neni 51-Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes,Neni 52–Njoftimi i kritereve për dhënie të kontratën ,Neni 56 –Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave , Neni 59–Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,Neni 60-Kriteret për dhënie të kontratën,Neni 69- Aftësia teknike dhe ose profesionale

Dhe pas dhënies së vendimit , ka vepruar në Kundërshtim me dispozitën e nenit 108/A të LPP-së duke mos shqyrtuar fare Kërkesat për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

Duke pasur parasysh shkeljet e lartecekura nga Autoriteti Kontraktues, kërkojmë që kjo procedurë e prokurimit të kthehet në rivlerësim per Lot 1 dhe Lot 3.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Janë dëme të konsiderueshme të cilat i janë shkaktuar Kompanisë Sallahu, pasi që kemi bërë të gjitha përgatitjet, dhe kompletuar të gjithë dokumentacionin me përpikëri me qëllim të realizimit të kontratës si operatorë i përgjegjshëm dhe me çmimin me te ulet , dhe nga ky vendim jo ligjor i AK jemi dëmtuar shumë, edhe nga aspekti material.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues
b) Leter standard per tenderuesin e eliminuar – Sallahu & Salillari
c) Kërkesë për rishqyrtim , dt 27.04.2022
d) Deshmi per OE Sallahu dhe Salillari
e) Deshmi per OE Damastion
f) Deshmi per OE Lika Trade
g) Kërkesë për sqarim/interpretim në KRPP , dt 28.04.2022

h) Kërkesë/Njoftim tek Autoriteti Kontraktues dt 12.05.2022
i) Kërkesë për Montiorim në Departamentin e Rregullave KRPP , dt 12.05.2022
j) Interpretim/Sqarim nga KRPP Departamenti i Rregullave dt 12.05.2022
k) Kërkesë/Njoftim tek Autoriteti Kontraktues dt 13.05.2022

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kapaciteti ekonomik dhe financiare dhe kapaciteti teknik dhe profesional.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE-te ankues janë te papërgjegjshëm
OE-te e rekomanduar per kontratë janë te përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues "Graniti":
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP, pretendon se AK-ja pa te drejte e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ne fjale dhe njëherit kërkon qe Lot 2 dhe 3 te kthehen ne rivlerësim me arsyetimin se i kemi plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Graniti eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Granit SH.P.K., Jakup Ferri 25, 31000, Istog
  - Bazuar ne Dosjen e Tenderit, krahasimin dhe vlersimin e ofertes – Operatorik Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.
  - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 pika 8. - Kapaciteti teknik dhe professionale – Plani veprimit dhe shperndarjes se kripes sipas Specifikacionit teknik te DT.
  - Deshmia 8. - Plani duhet te jete i pergaditur ne menyre sa me te detajuar, i nenshkruar dhe vulosur .
  - Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT - FDT-së, pasi qe ne oferten e tije, Operatori Ekonomik nuk ka ofruar Plani veprimit dhe shperndarjes se kripes sipas Specifikacionit teknik te DT, pasiq ne oferten e tije OE „Granit" ka ofruar vetëm disa vizatime te cilat nuk permbushin kerkesat sipas specifikacionit teknike dhe askund nuk permendet koha e reagimit e cila eshte max. 2 orë, duke marre parasyshe

[3]Të raportohet në çdo dokumentë apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

1

lokacionin e bazes se prezantuar e cila gjindet ne nje largesi te konsiderueshme, andaj kjo largesi paraqet problem ne kohen e reagimit, duke marre parasyshe se plani i veprimit dhe reagimit eshte i rendesishe se veçant per menaxhimin e te reshurave atmosferike te Borës gjate sezonit te dimrit.

  - OE bazuar tek Seksioni II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Aneksi 1. nuk ka bashkangjitur ne oferten e tije SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Sa i përket arsyes se pare te eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, pretendon se AK-ja, e ka eliminuar per nje kerkese e cila nuk ekziston ne dosjes te tenderit, konkretishte pretendon se "Ne specifikimet

teknike te autoritetit kontraktues askund nuk permendet koha e reagimit e cila është Max. 2 ore".

Lidhur me kete pretendim eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim dhe arsyetim i OE ankues, nuk qëndron per faktin se ne faqen nr: 24 dhe 25 te specifikacionit teknik te detyrueshëm, ne piken 4.3 - **Pastrimi i Borës,** autoriteti kontraktues ka kerkuar:

Heqja e borës do të fillojë brenda 30 minutave kur fillon të bjere bora. Të gjitha korsitë, si dhe rrugët lidhëse me autostradën duhet të pastrohen brenda një periudhe prej **dy orësh** pas njoftimit të kushteve të dëborës.
Cikli i rotacionit të mjeteve të pastrimit të dëborës do të jetë 120 minuta.
Prandaj, arsyetimi se nuk eshte kërkuar dhe se nuk permendet ne asnjë pike te specifikacionit teknik nuk qëndron dhe gjitheashtu eksperti shqyrtues, sqaron se lidhur me kete pike AK-ja, ne komisionin vlerësues ka emëruar edhe inxhinier te cilët kan bere vlerësim profesional te planit veprimit dhe shperndrajes se kripës sipas specifikacionit teknik te detyrueshëm.

Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit, eksperti shqyrtues, vlerëson se mos dorëzimi i specifikacionit teknik ne ofertën e tij eshte i pa drejte dhe nuk mund te eliminohet nje operator ekonomik.

OE ankues Graniti, ne ankesën e tij pretendon se i rekomanduarit per kontrate per Lot 2 eshte i papërgjegjshëm dhe njëherit pretendon se ps publikimit te vendimit te AK-se, kemi kërkuar qasje te dokumentet zyrtare dhe se AK-ja, i ka dhene pjesërisht qasje me arsyetimin se OE i rekomanduar per kontrate ka kerkese per sekret afarist. Fillimisht eksperti shqyrtues, sqaron se i rekomanduari per kontrate ka bere kerkese per sekret afarist dhe i njëjti me marrëveshje eshë dhe lideri i grupit te operatoreve ekonomik, ndërsa sa i përket pjesës ne te cilën thuhet se AK-ja eshte dashur te na ofroje me shume dëshmi, eksperti shqyrtues sqaron se ne legjislacionin ne fuqi nuk përcaktohen se cilat dëshmi mund te konsiderohet si sekret afarist.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari per kontrate per Lot 2, nuk e plotëson kerkese e dosjes se tedenrit lidhur me kontratat dhe referencat, duke pretenduar se OE ABC dhe B-Corp, nuk kan qene pjesëmarrës ne kontrata e realizuara nga OE 2A Group, ekseprti shqyrtues, sqaron se te njëjtit sipas dëshmive kan qene realizuar punime ne projektin ne fjal, prandaj ky pretendim eshte i paqëndrueshëm dhe se OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar mjaftueshëm dëshmi lidhur me kërkesën e AK-se per kontrata dhe referenca.

OE ankues Graniti, ne ankesën e tij pretendon se grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate nuk i kan ofruar deshmit sipas kërkesës se dosjes se tenderit, duke pretenduar se disa pajisje te ofruar ne oferte nuk janë ne pronësi te konzorciumit te rekomanduar per kontrate per Lot 2.
Eksperti shqyrtues lidhur me kete pretendim sqaron se konzorciumi i rekomanduar per kontrate ka ofruar dëshmitë – kontrata te blerjes se pajisjeve, fatura te blerjes dhe DUD-a doganor me te cilat dëshmon se i ka ne pronësi apo ne shfrytëzim. Lidhur me kete pretendim eksperti shqyrtues për shkak te sekretit afarist nuk mund ti publikoje te gjitha dëshmit e ofruara.

Sot, me datë 14/09/2020 (Katrëmbëdhjetë Shtator Dymijëenjëzet), para meje, SINAN VISOKA, Noter me seli në Podujevë, rruga "Rr. "Nuhi Gashi" p.nr.,me kërkesë që në bazë të vullnetit të tyre të lirë të përpiloj aktin notarial Kontratë për shitblerjen e automjeteve u paraqitën palët kontraktuese si në vijim:----------

ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION SHPK ,me numër unik identifikues 810492637,me seli në Prishtinë, Ndue Përlleshi (Kompleksi Alko -Impex) , me pronar IMER ADEMI i lindur me datë 18/02/1957(Tetëmbëdhjetë Shkurt Njëmijëenënëntëqinde Pesëdhjetëeshtatë), në Prishtinë, shtetas Kosovar , identitetin e të cilit e konstatova në bazë të leternjoftimit me numër personal 1011458145 lëshuar nga MPB e Republikës Kosovës,të cilin e përfaqëson me autorizimin numër 3849/2020 I dates 28.07.2020 Remzije Shala-Sylejmani e lindur me datë 29/04/1989 në Mitrovicë,shtetase kosovare,e identifikuar me letërnjoftimin me numër personal.1170815443, madhor me zotësi të plotë veprimi (në tekstin e mëtejmë: Shitësi)----------

---

2 A Group " SH.P.K., me seli në Hyzri Talla Qendra Tregtare Bregu i Diellit - Prishtinë, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrim të Biznesit me numër unik identifikues 810846800 ,me epronar VALON ADEMI i lindur me datë 11.07.1987 (Njëmbdhjetë korrik Një mijë e nentqind e tetdhjetëe shtatë) në Prishtinë , bartës i dokumentit të identifikimit leternjoftimit me nr. personal1171934687, të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, me 24.07.2014 i vlefshëm deri me 23.07.2024, të cilin e përfaqëson me autorizimin numër 6693/2020 I dates 14.09.2020 Homdije Idrizi-Krasniqi e lindur më datë 02/02/1976 në Preshevë ,shtetase Kosovare,e identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal 1014492590 , madhor me zotësi të plotë veprimi (në tekstin e mëtutjeshëm: Blerësi)----------

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se i rekomanduari per kontrate ka ofruar traktor Imt – 539 dhe i njëjti nuk e plotëson kërkesën e AK-se, ku eshte kërkuar Traktor me fuqi min 60 KF dhe poashtu pretendon se i rekomanduari per kontrate nuk ka ofruar cilindra vibrues sic janë kërkuar.
Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dëshmit e ofruara per pajisjet e pretenduara sqaron se ne dëshmit e ofruara per Traktorin nuk specifikohet fuqia prej 60 KF ndërsa sa u përket cilindrave te ofruara janë sipas kërkesës se DT-se. Sa i përket çështjes se fuqisë prej 60 KF, per te cilat OE ankues pretendon se nuk e plotëson eksperti shqyrtues vlerëson se mund te konsiderohet si devijim i vogël konform nenit 59.4 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit te OE ankues se i rekomanduari per kontrate per Lot 3, konkretisht OE Via, ne vërtetimin e ATK-se te dorëzuar figuron se i njëjti ka borxhe te pashlyera dhe se eshte ne marrëveshje me këste per ti shlyer borxhet tatimore te mbetura.
Eksperti shqyrtues duke u bazuar edhe ne praktikat e rasteve te ngjashme OSHP, ka nxjerr disa vendime per te cilat nuk i ka eliminuar operatoret ekonomik per faktin se te njëjtit janë ne marrëveshje per ti shlyer obligimet, prandaj edhe ky pretendim eshte i paqëndrueshëm.

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues "Integral":
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP, pretendon se AK-ja pa te drejte e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ne fjale dhe njëherit kërkon qe Lot 2 dhe 3 te kthehen ne rivlerësim me arsyetimin se i kemi plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Integral eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Grup i Operatorëve Ekonomik INTEGRAL Sh.p.k.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.; NITI - N SH.P.K., Ahmet Krasniqi, 10000, PRISHTINË

  - Bazuar ne Dosjen e Tenderit, krahasimin dhe vlersimin e ofertes - Operatorik Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.
  - Bazuar ne Dosjen e Tenderit, krahasimin dhe vlersimin e ofertes - Operatorik Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit
  - **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare – neni 8.1 dhe 8.2**
  - Kapaciteti ekonomik dhe financiar -
  - Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku Loti I. 1,080,000.00 € , Loti II. 900,000.00 € , Llot III. 600,000.00 € dhe Llot IV. 660,000.00 € , ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia.

- Deshmija 2 - Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni.
- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT - FDT-së, pasi qe ne oferten e tije Operatori Ekonomik ka ofruar doukemt nga Banka nga antari i konzorciumit Milenium Konstruktion shpk ne vleren prej 187,036.83 dhe nje tjeter doukemt nga Banka nga antari i konzorciumit Integral shpk ne vleren prej 50,647.03 ku ku keto vlera ne total kipin shifrat 237,683.86 €te cilatjane ne kundershtim me kerkesat e DT dhe te FDT-së, pasi qe nuk kapin shumen minimale per: Loti II. 900,000.00 € , Llot III. 600,000.00 € dhe Llot IV. 660,000.00 € .
- OE bazuar tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Aneksi 1. nuk ka bashkangjitur ne oferten e tije SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e pare te eliminimit sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar:

Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose qasje ne kredi te pa kushtëzuar, **nga një bankë duke emërtuar projektin për te cilin lejohet kredia.**
Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dëshmit e ofruara sqaron se OE ankues, ne ofertën e tij i ka dorëzuar dy konfirmime bankare te cilat arrijn shumen prej: 238,000.00€, dhe nje vërtetim nga Procredit Bank, ne vlere prej: 688,980.53€, i cili është vërtetim i qarkullimit bankar per periudhën prej: 01.01.2021 deri me 11.03.2022. Vlen te permendet fakti se ne asnjërën prej dëshmive te përmendura me lart nuk eshte emertuar projekti sic eshte kërkuar ne dosje te tenderit.

Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit, eksperti shqyrtues, vlerëson se mos dorëzimi i specifikacionit teknik ne ofertën e tij eshte i pa drejte dhe nuk mund te eliminohet nje operator ekonomik.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, qe ka te beje me pajisjet dhe mekanizmin e obligueshëm per mirëmbajtjen dimerore A7, per te cilin pretendon se i rekomanduari per kontrate per Lot 2 nuk ka ofruar dëshmi, eksperti shqyrtues, sqaron se me poshtë e gjeni tabelën e plotësuar ne tërësi dhe per këto ka ofruar dëshmi marrëveshje per shfrytëzim te parcelës, skica dhe plane te detajuara. Per shkak te kërkesës per konfidencialitet, eksperti shqyrtues, sqaron se nuk mund ti beje publike dëshmit ne fjal, mirëpo te njëjtat do te ja prezantoje panelit shqyrtues me rastin e organizimit te seancës degjimore.

V. 2) PAJISJET DHE MEKANIZMI I OBLIGUESHËM PËR MIRËMBAJTEN DIMËRORE - A7 PËR LLOT:

1	Kërkesat minimale për objektet Përcjellëse PËR LLOT:	Sasia e kërkuar	Sasia që ofron ofruesi	Të dhënat për objektet 1: Lokacioni me Parcelë dhe skica (Plani i situacionit të objekteve në Përpjesë 1:50 dhe Legjendë për destinimin e ktinesve)
1.1	Garazhë e Mbuluar për Automjete dhe	1	1	P-73414042-01897-1
1.2	Punëtoria me dhomë për ruajtje (depo)	1	1	
1.3	Vend për ruajtjen e karburanteve për shërbime	1	1	
1.4	Strukturë të furnizimit me energji elektrike	1	1	
1.5	Zonë e mbyllur për ruajtjen e kripës me platformë per ngarkesë – kapaciteti 750 t	1	1	
1.6	Qendra e përkohshme e komunikimit	1	1	
1.7	Dhomat për stafin dhe punëtorët	4	4	

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues "Via Egnatia":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP, pretendon se AK-ja pa te drejte e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ne fjale dhe njëherit kërkon qe Lot 2 dhe 4 te kthehen ne rivlerësim me arsyetimin se i kemi plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Via Egnatia eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- <u>Grup i Operatorëve Ekonomik VIA EGNATIA SH.P.K.; GASHI ING SH.P.K; HUMOLLI-S - PETROL SH.P.K.; VIV GROUP L.L.C., Rr. Mustafë Veselaj, 10000, Prishtinë</u>
  - Bazuar ne Dosjen e Tenderit, krahasimin dhe vlersimin e ofertes - Operatorik Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.
  - **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - neni 8.1 dhe 8.2**
  - Kapaciteti ekonomik dhe financiar -
  - Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku Loti I. 1,080,000.00 €, Loti II. 900,000.00 €, Llot III. 600,000.00 € dhe Llot IV. 660,000.00 €, ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia.

- Deshmija 2 - Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka njohje të pushime në shërbimbogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni.
- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT – FDT-së, pasi qe ne oferten e tije Operatori Ekonomik ka ofruar nje Deklaratë nga Banka e cila eshte ne kundershtim me kerkesat e DT dhe te FDT-së, pasi qe ky dokument eshte leshuar ne forme te kushtezuar.
- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Neni 9.1 dhe 9.
- Kapaciteti teknik dhe professional
- Menaxheri i Projektit Inxhinier i diplomuar 3 vite përvojë punë pas diplomimit, ose bechelor 5 vite pervoj pune pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e Mirëmbajtjes , te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale .
- Deshmia 1 - Kopje e diplomes përkatëse e noterizuar nga vetë inxhinieri, CV e nenshkruara nga inxhinieri, kontrata e punës me ofertuesin të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punëmarrësit, Referencat për Inxhinierin duhet te leshohen nga kompanija te cilat duhet te jene te deshmuara perms proqesverbaleve per pranime teknike perfundimtare për projektin ne te cilin ka qene i angazhuar dhe ku eshte dhene referenca.
- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, menaxheri i projektit i caktuar per kete aktivitet te prokurimit, i mungon kontrata e noterizuar sipas kerkesave te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se kontrata e punës me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndersa kontrata e menxherit te projektit eshte e noterizuar vetum nga punemarrsi (menaxheri i projektit) e jo edhe nga punedhenesi (kompanija), andaj kjo kontrate pune, bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së
- Udheheqes i Punishtes Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë - 3 vite përvojë pune ose bechelor 5 vite pervoj pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes, minimum dy (2) projekte të realizuara në lëminë e Mirëmbajtjes, te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale .
- Deshmia 2 - Kopje e diplomes përkatëse e noterizuar nga vetë inxhinieri, CV e nenshkruara nga inxhinieri, kontrata e punës me ofertuesin të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punëmarrësit, Referencat për Inxhinierin duhet te leshohen nga kompanija te cilat duhet te jene te deshmuara perms proqesverbaleve per pranime teknike për projektin ne te cilin ka qene i angazhuar dhe ku eshte dhene referenca.
- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, Udheheqes i Punishtes i caktuar per kete aktivitet te prokurimit, i mungon kontrata e noterizuar sipas kerkesave te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se kontrata e punës me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndersa kontrata e menxherit te projektit eshte e noterizuar vetum nga punemarrsi (menaxheri i projektit) e jo edhe nga punedhenesi (kompanija), andaj kjo kontrate pune, bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së. Udheheqes i Punishtes ka te prezantuar vetum 1 reference nga lemija e kerkuar .
- Inxhinier i diplomuar i komunikacionit - me 2 vite përvojë pune pas diplomimit ose Barchelor i diplomuar i komunikacionit me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.
- Deshmia 3 - Kopje e diplomes përkatëse e noterizuar nga vetë inxhinieri, CV e nenshkruara nga inxhinieri, kontrata e punës me ofertuesin të jetë e noterizuar në prani të punëdhënësit

dhe punëmarrësit, Referencat për Inxhinierin duhet te leshohën nga kompanija te cilat duhet te jene te dushmuara perms proqesverbaleve per pranime teknike perfundimatere për projektin ne te cilin ka qene i angazhuar dhe in eshte dhene referenca. Vrejtje: Nëse Operatori Ekonomik nuk ka ne përbërjen e stafit të tij inxhinierët e lartcekur atëherë mund të angazhoj staf për këtë projekt (me kohëzgjatje të projektit dhe emër të projektit)- si dëshmi të prezantoj një para Kontratë për angazhimin e tyre për këtë projekt e noterizuar në mes dy palëve.

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, Inxhinier i diplomuar i komunikacionit i caktuar per kete aktivitet te prokurimit, i mungon kontrata e noterizuar sipas kerkesave te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se kontrata e punës me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar, ndersa kontrata e Inxhinier i diplomuar i komunikacioniteshte bere jasht zyres se noterit, andaj kjo kontrate pune, bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së.

- Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e Mirëmbajtjes , te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale, për periudhën e shkuar tre vjeçare (2019, 2020 dhe 2021) jo më pak se Llot 1 = 5,400,000.00 €, Llot 2 = 4,500,000.00 € , Llot 3 = 3,000,000.00 € dhe Llot 4 = 3,300,000.00 €, Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e Mirëmbajtjes, te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale.

- Deshmija 4. Kopje te kontratave dhe Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e Mirëmbajtjes, per periudhën e shkuar tre vjeçare, kontratat e sektorit privat duhet te jene te shoqruara me referenca dhe proqesverbale te pranimit te punëve .

- Operatori Ekonomik nuk ka arritur ta permbushe kete kerkese te DT dhe FDT-së, lista e kontratave nuk permbushin kerkesat te DT dhe FDT-së, ku kerkes ka qene se OE duhet te kete kontrata te realizuara dhe te perfunduara ne lëmine e Mirëmbajtjes, te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale, për periudhën e shkuar tre vjeçare (2019, 2020 dhe 2021) jo më pak se Llot 1 = 5,400,000.00 €, Llot 2 = 4,500,000.00 €, Llot 3 = 3,000,000.00 € dhe Llot 4 = 3,300,000.00 €, Operatori ekonomik ka prezantuar kontrata ne vlere prej 1,840,000.00 € nga lemia e Mirëmbajtjes , te Autostradave, Rrugeve Nacionale, Regjionale dhe Lokale, për periudhën e shkuar tre vjeçare (2019, 2020 dhe 2021), andaj kjo kerkese bie ne kundershtim me kerkesat e DT dhe FDT-së.

- OE bazuar tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Aneksi 1. nuk ka bashkangjitur ne oferten e tije SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Sa i perket arsyes se pare te eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ka ofruar nje letër konfirmim nga banka ne te cilën thuhet se nëse shpallet fitues banka synon te beje vlerësimin e kapaciteteve financiare te kompanisë, pra sipas deshmise se lëshuar nga banka, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk eshte sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Sa i përket arsyeve tjera te eliminimit, qe kane te bëjnë me noterizimin e kontratave sipas kërkesës, mungesës se përvojës se udheheqesite te punishtes, listës se kontratave, eksperti shqyrtues, vlerëson se per te njëjtat arsye AK-ja, kontretishte komisioni vlerësues, ka mundur te kerkoje sqarime lidhur me dëshmit e lartpërmendura, por fakti qe OE ankues, nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me dëshmin e bankës se operatori ekonomik ka kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose qasje ne kredi te pa kushtëzuar, e ben te pandryshuar kualifikueshmerin e operatorit ekonomik, sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e cituar me larte.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate, eshte i papërgjegjshëm me arsyetimin se ka ofruar pajisje te cilat nuk janë te regjistruara, eksperti shqyrtues, sqaron se bazuar edhe ne praktikat e mëhershme, nuk mund te eliminohet nje operator ekonomik, me kete arsyetim per faktin se me ofrimin e dëshmive lidhur me pajisjet operatoret ekonomik deshojn se i kan pajisjet, pra me kete rast ofrojn dëshmi minimale te kualifikueshmerise ndërsa afati i regjistrimit te automjetit mund te vazhdohet ne cdo kohe pas përfundimit te regjistrimit. Poashtu sa i përket pretendimit te OE ankues, i cili ne ankesën e tij i ka përmendur disa automjete te OE te rekomanduar per kontrate, per te cilin pretedon se nuk janë ne pronësi dhe se nuk janë ne sistemin shteterore, ekseprti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim dhe bazuar ne kërkesën per sekret afarist, ekseprti shqyrtues do ta publikoje vetëm njërin nga pajisjet me te cilën dëshmohet se eshte ne pronësi te OE te rekomanduar per kontrate, ndërsa provat tjera do ti prezantoj para panelit shqyrtues.



Sa i përket pretendimit te OE ankues, se menaxheri te projektit i OE te rekomanduar per kontrate per Lot4, Burim Llullaku, nuk ka deshmuar ne CV-in e tij se ka pervoje dhe per te njëjtin pretendon se akti noterial eshte bere nga kompania e jo nga vet personi sic eshte kërkuar ne DT, eksperti shqyrtues sqaron se ne ofertën e tij i rekomanduari per kontrate per menaxherin e projekti i ka ofruar dy referenca per mirëmbajtje te projekteve dhe poashtu eshte i paqëndrueshëm pretendimi se nuk ehste bere noterizimi nga vet personi.

VERTETIM I FOTOKOPJES NGA DOKUMENTI ORIGJINAL

NOTER Ylli Mekaj, noter në Pejë, me seli në rr.„General Wesley Clark" nr.10, me datë njëzetetetë shtator dymijenjëzetenjë, me kërkesën e : ----------

Burim (Isuf) Llullaku, lindur me 30.09.1981 në Istog ku edhe banon shtetas i Kosovës, u identifikua nga etërnjoftimi me nr. ID0615220 dhe me nr.pr. 2009082487, lëshuar nga MPB/RKS, me zotësi veprimi.----------

VERTETON SE: ----------

Kopja e vertetuar është identike me origjinalin të sjellë nga pala të quajtur **„DIPLOMË"**.----------

Fotokopja u bë në zyrën noteriale.----------

Dokumenti i vertetuar ka dy fletë dy faqe dhe vertetohet në dy kopje. ----------

Pala deklaron se dokumenti nuk është ndjerrë në mënyrë të kundërligjshme dhe i njëjti u njoftua për pasojat e deklarimit të rremë. ----------

Shpenzimet noteriale paguhen në bazë të UA 02/2012, tarifat e përkohshme noteriale sipas nenit 27, plus 18% TVSH-ja. Në zyrën noteriale në Pejë, rr. „GeneralWesley Clark" nr.10.----------

NOTER
YLLI MEKAJ

Poashtu eshte i paqëndrueshëm pretendimi lidhur me udhëheqësin e punishtes me arsyetimin se nuk eshte bere nga vet Urim Kastrati si udhëheqës i punishtes.

LRP.nr.2014/2021----------

VERTETIM I KOPJES NGA DOKUMENTI I ÇERTIFIKUAR--

*Unë Zyfer Aliu, Noter në Lipjan, Rr. "Lidhja e Prizrenit" p.n, me kërkesë të **Z.Urim Kastrati** , i lindur në F.Lubizhdë-Malishevë , më datë **29.05.1978** (njëzet e nëntë maj njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) , me vendbanim në F.Lubizhdë-Malishevë , shtetas i Republikës së Kosovës, bartes i leternjoftimit me nr. personal **1016134666** , lëshuar nga MPB-Prishtinë më 06.01.2021 , valid gjerë më dt.05.01.2031 , madhor , me zotësi të plotë veprimi, vërtetoj se dokumenti bashkangjitur **"Diplomë" e kualifikimit universitar , me nr.124 , e lëshuar më dt. 15.12.2003 , leshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë , në emër të Urim Ali Kastrati** , dokument i cili ka **2 flete dhe 3 faqe**, përputhet në çdo aspekt me dokumentin e çertifikuar më parë se me dokumentin origjinal i cili nuk më është prezentuar.*----------

---

Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në Zyrën time, ndersa dokumenti i çertifikuar ndodhet tek pala----------

*Në mbështetje të nenit 43, pika 3.2. të Ligjit nr. 03/L-010 "Për Noterinë", të njejtin e vërtetoj, Tarifa noteriale në shumë 1€ x 3 faqe =3€ x 2 kopje = 6€ +1.50€ vendosjen e vinjetit të vulës (neni 41 par.6)=7.50€ + 0.40€ për fotokopje (neni 41.5 i TPN)=7.90€+18% TVSH= **9.32€ (nëntë euro e 32/100)** për faqe, është paguar konform nenit 27 të UA, Nr.02/2012, mbi Tarifat e përkohshme noteriale.* ---

Lipjan , 07.03.2022 (shtatë mars dymijë e njëzet e dy) .----------

---

Noter:

Zyfer Aliu

Sa i perket pretendimit te OE ankues se kontrata e te rekomanduarit per kontrate me OE Bageri eshte per periudhën per nje vite e gjashte muaj, pra sipas OE ankues nuk eshte periudhës se kërkuar nga AK-ja, nuk qëndron per faktin se ne nenin 3 te kontratës thuhet:

----------Neni 3 ----------

1. Kontrata mbi qiranë sipas marrëveshjes së palëve do të zgjasë 1 vit e gjashtë muaj përkatësisht

18 muaj (një vit e gjashtë muaj përkatësisht tetëmbëdhjetë muaj) dhe ate duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës , perkatesisht gjerë ne skadimin e kontrates per sherbimet me autoritetin kontraktues dhe ate me mundësi vazhdimi edhe për nje periudhe te caktuar kohore sipas nevojave te qiramarresit me pelqimin e qiradhenesit , andaj palët me këtë kontratë lidhin kontratën te noteri për periudhën vijuese si më lartë, me obligim që pas skadimit të afatit kontraktues palët të mund te vazhdojnë kontratën pogese e gjejnë interesin e përbashkët edhe për pesë vitet e ardhshme.-----

OE ankues pretendon se marrëveshja ndërmjet Kosova asfaltit dhe kompanisë Arbotek eshte pa afat dhe rrjedhimishte nuk eshte valide, ekseprti shqyrtues sqaron se marrëveshja ne fjale ndërmjet dy kompanive ka per qellim furnizimin me asfalt per projektin ne fjale per te cilin edhe e kan emërtuar me titull te projektit per te cilin furnizuesi eshte i obliguar ta respektoj marrëveshjen.

Lidhur me pretendimin se i rekomanduari per kontrate ne ofertën e tij te plani i menaxhimit dhe shperndrarjes se kripës nuk e ka cekur ne asnjë pike te saj kohen e reagimit e cila nuk duhet te jet me shume se 2 ore.
Eksperti shqyrtues, sqaron se ne planin e menaxhimit OE i rekomanduar per kontrate ka dhene ne menyre te detajuar tere procesin e shperndarjes se kripës per Lot 4 ku i njëjti ne baze te lokacionit te paraqitur – zona kadastrale Biqec dhe hartës te cilën e ka dorëzuar ne ofert rezulton qe koha e reagimit eshte max. 25 minuta, prandaj ky pretendim eshte i paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka disa pretendime ankimore lidhur me disa fatura per te cilat pretendon se nuk i ka te deklaruar ne ATK i rekomanduari per kontrate per Lot 4 por per pretendime te njëjta ekseprti shqyrtues sqaron se nuk eshte kompetence e OSHP te konstatoje per nje pretendim te tille dhe njëherit lidhur me pajisjet i konteston numrat serik te dud-ve doganor.

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues "Sallahu":
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP, pretendon se AK-ja pa te drejte e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ne fjale dhe njëherit kërkon qe Lot 1 dhe 3 te kthehen ne rivlerësim me arsyetimin se i kemi plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Sallahu eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

Grup i Operatorëve Ekonomik- SALLAHU SH.P.K.; SALILLARI, Rr.Baki Dullovi Nr.158, 71000, Kaçanik

- Bazuar ne Dosjen e Tenderit, krahasimin dhe vlersimin e ofertes, bazuar ne LPP-në, Rregulloren dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publike neni 39 thuhet: Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshëm.
- OE ne oferten e tije tek formulari i dorezimit te tenderit ka ofruar dy lloje te çmimeve (çmim njesi per 1 vitë dhe për 2 vite tjera ka ofruar çmimin sipas sasive indikative), po ashtu OE ne oferten financiare ka ofruar variacione te çmimeve e cila nuk eshte e lejuar konkretisht tek pozicionet 2, 6.13, 7.11, 7.16, 9.2, dhe 10.1 çmimet e ofruara per te njetat pozicione ndryshojne neper vite, me qe rast edhe totalet neper vite ndryshojn, ku me pastaj te njejtat i ka mbledhur dhe i ka vendosur ne formularin e dorzimit te tenderit, dhe si rrjedhoje kjo paraqet mosperputhje ne mes te ofertes se prezantuar çmimi njesi dhe çmimit te ofruar ne formualarin e dorzimit te tenderit, nga kjo rezulton se formulari per dorzimin e tenderit nuk eshte plotsuar si duhet dhe si i tille eshte ne kundershtim me nenin 39 te Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publike, ku thuhet: Formulari i tenderit i cili nuk është plotësuar si duhet apo mungon refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshëm.
- Grupi i OE ne Lot 1 ka paraqitur oferte financiare ne vlere prej 2,008,259,70 euro e cila paraqet tejkalim te buxhetit ku sipas planifikimit vlera ka qene 1,828,000.00 Euro.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e pare te eliminimit, sqaron se OE ankues Sallahu, ne ofertën e tij financiare ne disa pozicione te njëjta sic janë përmendur dhe me larte te arsyet e eliminimit, ka dhene çmime te ndryshme te cilat ndryshojnë neper vite:

6.13	Riparimet e vogela te krahëve te urave dhe lëshesave me beton C30/37 duke përfshirë edhe armirimin	m3	1.00	130.00	130.00

6.13	Riparimet e vogela te krahëve te urave dhe lëshesave me beton C30/37 duke përfshirë edhe armirimin	m3	1.00	50.00	50.00

Eksperti shqyrtues sqaron se kjo kontrate eshte kontrate tri vjeqare dhe fakti qe OE ankues ka dhene çmime te ndryshme ne pozicione te njëjta, duhet te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, per faktin se sipas dipozitave te nenit 59 mbizoteron çmimi per njësi ku ne rastin konkret nuk dihet sakt çmimi per njësi dhe njëherit ky fakt

bie me nenin 18.29 te RrUOPP-se, ku thuhet se: "Çmimet e deklaruara në tender dhe çmimet e mëtejshme në kontratat e dhëna janë çmime fikse dhe të obligueshme për palët e kontratës. Çmimet nuk mund të ndryshohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës...". ne rastin konkret çmimet e OE ankues ankues ndryshojnë neper vite.

Prandaj, pretendimi i OE ankues se "*fakti qe paramasa eshte e ndare ne tri vite na mundëson qe sipas analizave te hulumtimit te tregut dhe politikave te kompanisë te ofertojmë me çmim te ndryshme per vite te ndryshme, pra* sipas OE ankues, *nuk ekziston asnjë norma ligjore qe e kufizon OE per me vendos çmimin sipas politikave përkatëse te seciles kompani*", nuk qëndron sepse sipas dispozitave te lartpërmendura te LPP-se, çmimi duhet te mbetet i pa ndryshuar gjate gjithë kohëzgjatjes se kontratës.

Lidhur me arsyen e dyte te eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, konkretisht komisioni vlerësues i ka zbatuar e nenit 59 te LPP-se, dhe ka ardh ne përfundim se OE ankues e ka tejkaluar vlerën e parashikuar te kontratës per Lot1.

Sa i përket interpretimeve te marra nga KRPP-ja, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron arsyetimi se formulari eshte plotësuar dhe se te njëjtit nuk i mungojnë te dhënat e nevojshme, por fakti se OE ankues ka ofertuar çmime te ndryshme neper te njëjtat pozicione.

OE ankues, pretendon se AK-ja, ka shpallur fitues per Lot 3 OE Damastion Projekt i cili nuk i ka plotësuar 188 pozicione ne paramasë dhe parallogari.
Eksperti shqyrtues, pasi ka ekzaminuar listën e çmimeve nuk ka vërejtur ndonjë pozicion te paplotësuar nga ana e te rekomanduarit per kontrate per Lot 3.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari per kontrate per Lot 3 nuk ka ofruar dëshmi lidhur me bazën e mirëmbajtjes, konkretisht pretendon se nuk ka ofruar dëshmi mbi pronesin apo fleta poseduese. Eksperti shqyrtues, sqaron se i rekomanduari per kontrate per Lot 3, ka ofruar ne ofertën e tij fletën poseduese, fotografi te bazës, vizatime te detajuara te objektit dhe përshkrime tjera te detajuara te bazës se mirëmbajtjes.

Sa i përket pretendimit lidhur me vertetimin e ATK-se, OE Eskavatori dhe OE Damastion Projekt, nuk i kan dorëzuar sipas kërkesës se dosjes se tenderi, kjo nuk qëndron per faktin se vërtetimet e ATK-se te operatoreve eekonomik te lartpërmendur janë ne harmoni me dispozitat e LPP-se dhe kushteve te parapara ne dispozitat e nenit 26 te RrUOPP-se.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate per Lot 1, ka ofruar disa skica me disa objekte, per te cilën ka ofruar fletën poseduese dhe se sipas OE ankues shfrytëzimi aktual eshte tokë bujqesore, ekseprti shqyrtues, sqaron se dëshmit e ofruara nga i rekomanduari per kontrate janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore, vlerëson se OE ankues nuk kan arritur te deshmojn interes material sipas nenit 4.1.26 te Ligjit per Prokurim Publik, per faktin se te njëjtit nuk i kan plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.
Sa u përket procedurave, eksperti shqyrtues, gjen shkelje nga ana e autoritetit kontraktues, sepse me rastin e parashtrimit te kërkesave per rishqyrtim autoriteti kontraktues nuk ka nxjerr vendim brenda afatit per kërkesat per rishqyrtim te dorëzuara nga OE-te ankues, dhe konsiderohet shkleje e procedurave te nenit 108/A te LPP-se.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të refuzohen si te pabazuara, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MMPHI.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE-ve ANKUES.